



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1186

OSHP: 2024/1191

OSHP: 2024/1200

OSHP: 2024/1202

OSHP: 2024/1232

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “AK Invest Dooel Tetovo & Hidro Project SH.P.K”, OE “4AM & Raf II”, OE “Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt&Imk -Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.”, ankesës së OE “Ada Consulting Group SH.P.K” si dhe ankesës së OE “BM Group” kundër B58Njoftim mbi vendimin e AK-se lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. të prokurimit: "206-23-14371-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 02.04.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Ada Consulting Group SH.P.K” me numër protokolli 2024/1186 e datës 09.12.2024, ankesa e OE “Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt & Imk -Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.” me numër protokolli 2024/1200 e datës 11.12.2024, si dhe ankesa e OE “BM Group” me numër protokolli 2024/1232 e datës 18.12.2024, të parashtruara për aktivitetin e prokurimit “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me numër të prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

2. Aprovohet, si e bazuar ankesae OE “AK Invest Dooel Tetovo & Hidro Project SH.P.K” me numër protokolli 2024/1191 e datës 09.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me numër të prokurimit 206-23-14371-

5-1-1.

3. Hedhet poshtë ankesa e OE “4AM & Raf II” me numër protokollit 2024/1202 e datës 11.12.2024, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit si në piken I të dispozitivit.

4. Anullohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Ministrisë së Shëndetësisë, për aktivitetin e prokurimit “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” me numër të prokurimit 206-23-14371-5-1-1, ndërkaq lënda kthehet në rivlerësim sipas arsyetimit në këtë vendim.

5. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatoreve Ekonomik Ankues. Në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.01.2024, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” me numër të prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 22,513,201.67 €.

Me 21.11.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Me datën 25.11.2024 OE “Ada Consulting Group” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Me datën 26.11.2024, poashtu kërkesë për rishqyrtim kanë parashtruar edhe operatorët ekonomik “Mabco Constructions” SH.P.K, “AK Invest Dooel”, “BM Group” SH.P.K dhe „Raf II” sh.p.k. Me datën 09.12.2024 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Ada Consulting Group SH.P.K” ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2024/1186 e datës 09.12.2024, OE ankues “AK Invest Dooel Tetovo & Hidro Project SH.P.K” ka parashtruar ankesë me nr. 2024/1191 e datës 09.12.2024, OE ankues “Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt & Imk -Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.”ka parashtruar ankesë me nr. 2024/1200 e datës 11.12.2024, OE ankues “4AM & Raf II” ka parashtruar ankesë me nr. 2024/1202 e datës 11.12.2024, si dhe OE ankues “BM Group” ka parashtruar ankesë me nr.2024/1232 e datës 18.12.2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesat e pranuara për të aktivitetin e prokurimit i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit

111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2024/1186, 2024/1191, 2024/1200, 2024/1202 si dhe ankesa 2024/1232 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim

Përgjigja e AK-MSh në lidhje me pretendimet Ankimore të “Ada Consulting Group” SH.P.K.

Sa i përket pretendimit të parë ankimor, ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit tuaj për mosplotësim të kërkesës mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, mbështetjes financiare nga bankat, konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse janë kërkuar sqarime shtesë konform vendimit të OSHP-se nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, dhe sqarimi i dhënë nga ProCredit Bank është si vijon: “Sa i përket pyetjes suaj lidhur me klientin Ada Consulting Group SITPK, me këtë email ne ju vërtetojmë/konfirmojmë që klienti Ada Consulting Group shpk, ka limit kreditor të aprovuar në vlerë 4,000,000.00 EURO në ProCredit Bank. Shumen e mjeteve të lartcekura/limitin kreditor, klienti mund ta shfrytëzojë për nevojat e biznesit duke përfshirë dhe për financim për projektin “Vazhdimi i Ndërtimit -Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK”, varësisht nga kërkesa e tij” Kjo nuk është marrë parasysh nga komisioni vlerësues të cilët kanë vlerësuar se ky konfirmim nga Pro Credit Bank e ndryshon materialisht dëshminë e ofruar nga OE në ofertën e tijë përmes letër referencë me nr. OT.02.2081, e datës 06.02.2024, ku theksohet e kundërta: “Klienti aktualisht nuk posedon limit kreditor, rrjedhimisht, ProCredit Bank do të konsiderojë përkrahjen financiare deri në shumën prej 4,000,000.00 euro, pas analizës financiare të kryer nga analistët tanë të kredive.”

Sipas komisionit vlerësues në këtë rast kemi ndryshim material në mes përmbajtjes së dokumentit të ofertës dhe konfirmimit nga banka, e cila bie ndesh me LPP në fuqi, konkretisht me nenin 59 të LPP-së, "Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve", një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e njoftimit të kontratës dhe dosjen e tenderit. Gjithashtu, një tender mund të konsiderohet si i përgjegjshëm edhe nëse përmban gabim ose paqartësi që mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit, ose devijime të vogla që nuk shkaktojnë ndryshime materiale nga kërkesat e njoftimit të kontratës dhe dosjes së tenderit, me kusht që devijimet të kuantifikohen dhe të merren parasysh gjatë vlerësimit.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor, ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit tuaj për mosplotësim të kërkesës 2 projektit të Klinikës së Ortopedisë, konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar.

Në lidhje me këtë pikë, vendimi i OSHP-se ka rekomanduar që: Lidhur me punimet me X-ray të Klinikës së Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimit teknik”, paneli shqyrtues konstaton se

AK edhe në këtë pikë duhet të veprojë sipas nenit 72 të LPP-së, të kërkojë sqarime shtesë lidhur me raportin e pranimit, më saktësisht të kërkojë dëshmi për këtë pikë të dosjes së tenderit. AK duhet të kërkojë sqarime shtesë nëse ky projekt ka përfunduar dhe është pranuar në tërësi nga AK-QKUK duke përfshirë edhe “Dyert XRay me hapje automatike”, në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së për dokumente ekzistenca e të cilave në mënyrë objektive mund të vërtetohet se kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Sipas vendimit të OSHP-se nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, janë kërkuar sqarime shtesë nga AK-QKUK për të verifikuar nëse projekti “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të bllokut operativ të Klinikës së Ortopedisë” ka përfunduar dhe është pranuar plotësisht, duke përfshirë elementet specifike si “Dyert XRay me hapje automatike”, në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së për dokumente

ekzistenca e të cilave në mënyrë objektive mund të vërtetohet se kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Nga QKUK kemi pranuar: - Procesverbalin e pranimit të pjesës së parë (dokumenti i prezantuar edhe në oferte) dhe - Procesverbalin e pranimit final të dt. 31.05.2024. Sipas këtyre dy procesverbaleve të ofruara nga QKUK, komisioni i vlerësimit ka rekomanduar se pranimi teknik final është realizuar me dt. 31.05.2024 - pas hapjes së ofertave që ka qene dt. 27.02.2024, andaj nuk është pranuar projekti në tërësi siç është potencuar në vendimin e OSHP-se.

Përgjigja e AK-MSh në lidhje me pretendimet Ankimore të OE “Mabco Constructions” SH.P.K

Sa i përket pretendimit të parë ankimor, rreth afateve kohore për rivlerësimin e aktivitetit rreth 70 dite, ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe në raste të caktuara në administratë janë evidente vonesa të tilla, për arsye të ndryshme objektive dhe subjektive. Fillimisht vonesa afër mbi dy javë është bërë për tërheqjen e anëtares së komisionit dhe derisa është zëvendësuar me tjetër, pastaj shqyrtimi i lëndës, sqarimet shtese, mos aftësia e duhur e anëtareve për të kuptuar dispozitat si duhet, e të ngjashme.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor, rreth arsyes së eliminimit lidhur me planin dinamik, konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse edhe pas sqarimeve shtesë konform vendimit të OSIP-se nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, mospërputhjet në mes planit dinamik të kërkuar dhe të ofruar nga ana juaj janë evidente, jo vetëm në formën e kërkuar sipas Aneksit 1, por edhe në përmbajtje, andaj i konfirmojmë arsyet e dhëna në B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 21.11.2024.

Sa i përket pretendimit të tretë ankimor, rreth arsyes së eliminimit lidhur me ISO 9001, 14001 dhe 45001, konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse këto certifikata edhe pse në NJK dhe DT janë kërkuar të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që të plotësohen, tekstualisht ka qene e precizuar se në rast të konsorciumit, kërkohet për të gjithë anëtarët e grupit. Kjo kërkesë është konfirmuar dhe ka mbetur në fuqi edhe në sqarimet shtese të datës 05.02.2024. Neni 26 - Grup i Operatorëve Ekonomik 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

Sa i përket pretendimit të katërt ankimor, rreth mangësive të ofertave tjera me çmime me të lira,

konsiderojmë se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, meqenëse gjate vlerësimit të aktivitetit, për shkak të volumit të madh të dokumentacionit, komisioni është fokusuar të defektet bazike, duke i konsideruar defektet e vogla si të kahshme, andaj meqenëse nuk është specifikuar se cilat janë ato defekte tjera nuk mund të konfirmojnë saktësinë e këtij pretendimi, por mbetet për trajtim gjate procesit rreth këtij aktiviteti.

Përgjigja e AK-MSh në lidhje me pretendimet ankimore të OE AK “Invest Dooel”

Sa i përket pretendimit të pare ankimor, ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit tuaj për mosplotësim të kërkesës mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, mbështetjes financiare nga bankat, - konsiderojmë se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Ju keni ofertuar me tre deklaratat bankare: Deklarata bankare (Bank Statement) nga HALK Banka - me vlerën 2 milion euro; Letër qëllimi (Letter of intent) nga STOPANSKA Banka - me vlerën 2 milion euro; Letër informimi (Information letter) nga SPARKASSE Banka - me vlerën 1,250,000.00 euro; Siç e dini fillimisht herën e pare, është pranuar vetëm Deklarata bankare nga HALKBANK me vlerën 2 milion euro, ndërsa u janë kontestuar dy dokumentet nga STOPANSKA Banka dhe SPARKASSE Banka, si të kushtëzuara meqenëse në kriterin e NJK dhe TD është kërkuar mbështetja të jete e pakushtëzuar:... mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion euro , dhe gjate fazës së tenderimit ju nuk keni bere pyetje sqaruese për këtë kriter, e as që e keni kontestuar si të tillë këtë kriter të tenderit. Vetëm Deklarata bankare nga HALKBANK ka specifikuar se: the client has unconditional access to a credit line for the realization of the contract in the amount of 2 million euro in accordance with the performed assessment of the Client's creditworthiness.

Përkthyer në shqip donë të thotë: ... klienti ka akses të pakushtëzuar në një linjë kredie për realizimin e kontratës në vlerë prej 2 milionë euro në përputhje me vlerësimin e kryer të aftësisë kreditore të klientit. Në dy dokumentet tjera nga STOPANSKA Banka dhe SPARKASSE Banka, nuk ceket siç është kërkuar për realizimin e kontratës, por specifikohet se: We hereby notify that this Letter of intent does not represent a bank guarantee.

Përkthyer në shqip donë të thotë: Ne ju njoftojmë se kjo letër nuk përfaqëson një garanci bankare.

Është i gabuar pretendimi juaj se ne nuk i paskemi të qarta kërkesat në lidhje me “mbështetje financiare” dhe “garanci bankare”. Ne e kemi të qarte se këto dy letra nuk janë Garancione bankare, siç janë p.sh. Garancionet e Ekzekutimit të punëve, ose Garancionet e defekteve, ose Garancionet e palëve të treta, dhe ne as që kemi kërkuar një garacion të tillë në këtë fazë, por potencimi i këtyre dy bankave se “kjo letër nuk përfaqëson një garanci bankare” për në ka nënkuptuar se banka në fjale përmes kësaj letrë nuk na garanton neve si AK, që mbështetja bankare është e sigurt apo e aprovuar, por kjo nënkuptohet si mbështetje e kushtëzuar sipas politikave të bankës. Pas sqarimeve të ofruara nga STOPANSKA Banka, mbështetja për projektin është fuqizuar, por komisioni vlerësues e ka kontestuar afatin e përgjigjes, meqenëse në kërkesën e AK i është dhënë afat prej 5 ditësh deri më 22.10.2024, ndërsa sqarimi është kthyer më 25.10.2024. Gjithashtu për komisionin ka krijuar paqartësi përgjigja nga HALKBANK e datës 25.10.2024, në emailin me pyetje drejtuar bankës tjetër SPARKASSE Bank.

Sa i përket pretendimit të dyte ankimor, për arsyen e dyte të eliminimit, rreth stafit profesional, noterizimit të kontratave të tyre, - konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse edhe gjatë rivlerësimit sikurse edhe në vlerësimin fillestar, për komisionin vlerësues kanë qene të pa pranueshme kontratat e kontestuar në formën si janë noterizuar. Në rast se do të pranoheshin si të tilla, atëherë kjo do të nënkuptonte trajtim jo të barabartë në mes ofertuesve, bie ndesh me nenin 7 të LPP-se, meqenëse ofertat tjera i kanë noterizimet nga origjinali, ndërsa në përshkrimin e noterizimeve tuaja theksohet: “Vërtetimi i kopjes nga kopja e zakonshme”...dokumenti i cili ka 1 fletë dhe 1 fajll, përputhet në çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me parë se në dokumentin origjinal, i cili është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në zyrën time.

Pala deklaron se origjinalin nuk e posedon një vetë, duke mos pasur asnjë qëllim tendencioz ndaj ofertës tuaj siç keni pretenduar, por vetëm mbi bazën e dëshmimeve në oferte, prapë në konsiderojmë se me të drejtë këto kontrata nuk janë të pranueshme për AK. Sa i përket pretendimit të tretë ankimor, për Njoftimin e Vendimit të AK të dt. 21.11.2024 për anulimin e tërësishëm të aktivitetit të Prokurimit, ky pretendim është i pa bazuar meqenëse pikërisht sipas nenit 62 të LPP-se, specifikohet se: 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1.një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Meqenëse shprehja “duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit” përfshinë rastin e mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Përgjigja e AK-MSh në lidhje me pretendimet Ankimore të OE “BM Group” SH.P.K.

Sa i përket pretendimit ankimor ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit dhe se ju e keni plotësuar Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme-ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë... - konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar. Sipas kriterit në NJK dhe DT është kërkuar të dëshmohet realizimi i projekteve të ngjashme..., kur thuhet i realizuar projekti nënkuptohet i përfunduar, meqenëse edhe si dëshmi - Lista e projekteve ndër të tjera është kërkuar - Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit, si dhe është kërkuar: Për çdo projekt të realizuar transaksionet financiare). Në si AK-MSh e konfirmojmë Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 21.11.2024 dhe arsyet e eliminimit të cekura në B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, meqenëse pas rivlerësimit dhe sqarimeve të kërkuara nga ana juaj, konform vendimit të OSHP-se nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, vërtetohet se ju nuk e plotësoni këtë kriter siç është kërkuar në NJK dhe DT. Komisioni gjatë rivlerësimit i kanalizuar projektet e ofertës tuaj dhe në tabelën me poshtë janë të detajuara të dhënat rreth tyre, vlerat, përqindjet e realizimit dhe afatet kohore.

Përgjigja e AK-MSh në lidhje me pretendimet Ankimore të OE “Raf II”

Sa i përket pretendimit ankimor 1, ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit se: Nuk e keni plotësuar Kërkesën 3. b) të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Në kuadër të udhëheqësve është kërkuar instalues gazi, OE e ka ofruar z. Nazmi Hoxha, i kualifikuar si teknik

i ngrohjes, për kaldaja me avull dhe një ujë te ngrohtë. Ky pretendim konsiderojmë se është pjesërisht i bazuar, meqenëse ne dokumentacionet e prezantuar për z. Nazmi Hoxha, të lëshuara nga Republika e Shqipërisë, dallojnë pak edhe emërtimet rreth profesioneve krahasuar me emërtimet e RK. Ne NJK dhe DT ne e kemi specifikuar 1 Instalues gazi, ku qëllimi i AK ka qene të instalues i gazit medicinal, por me qëllim që te mos ngushtohet konkurrenca e kemi specifikuar vetëm instalues gazi. Ne baze te kontratës se prezantuar ne oferte për z. Nazmi Hoxha, profesioni i tij është Kaldaist, ndërsa ne baze te certifikatës me nr. serik 00882, specifikohet kualifikimi për përdorimin e pajisjeve/instalimin nen presion, si dhe përshkrimi: Përdorues/operues/shfrytëzues te kaldajave me avull dhe me ujë/vajë te nxehtë. Duke marre parasysh se kërkesa e AK është për instalues gazi dhe faktin se terminologjia teknike e Republikës së Shqipërisë ka pak dallim me RK, termi i certifikimit instalimi nen presion si dhe kaldajave me avull, mund le konsiderohet i përafërt me kërkesën e AK-MSh. Ndërsa sa i përket kualifikimit te z. Samit Hasa, si saldues metali, AK nuk ka ndonjë vërejtje ne dëshmitë e ofruara për këtë pozite.

Sa i përket pretendimit ankimor 1 ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit se: Te Aneksi 1 i DT është kërkuar që OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit, max. 30 muaj. Planin Dinamik nuk e keni plotësuar si duhet jo në mënyrë reale për punët inxhinierie. Edhe këtë pretendim e konsiderojmë si pjesërisht te bazuar, meqenëse ne ofertën e juaj ju e keni ofruar Planin Dinamik duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit, por nga komisioni i vlerësimit te parë, u është kontestuar shtrirja e ditëve te punës neper pozicione, e jo si forme e plotësuar.

Kërkesa për Planin Dinamik nuk ka qene kriter për kualifikim, por kërkesa teknike sipas Aneksit 1 te DT, ku është kërkuar që OE duhet te dorëzojnë me Ofertën e tyre edhe “Planin Dinamik të Detajuar” duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit. Duke marre parasysh Vendimin e OSHP-së (nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367) trajtimin e Planit Dinamik me rastin e pretendimeve nga ankesa e OE ankues Mabco Constructions, me çrast paneli shqyrtues ka vlerësuar se: duke qenë se nuk ka legjislacion në fuqi në fushën e ndërtimit në Kosovë, dhe nuk është vërtetuar mjaftueshëm se a është apo jo plani dinamik i ofruar nga OE në harmoni me dosjen e tenderit... atëherë ky rekomandim vlen edhe për ofertën e juaj rreth planit dinamik te ofruar nga ju.

Pavarësisht trajtimit te dy pretendimeve tuaja ankimore si pjesërisht te bazuara, Kërkesa e juaj për rishqyrtim u refuzohet, bazuar ne faktin se herën e pare ju si OE i eliminuar nuk keni vazhduar me ankimimit tuaj ne fazën e dyte ne OSHP dhe ne këtë faze te rivlerësimit oferta juaj nuk është shqyrtuar nga komisioni i rivlerësimit, duke ju trajtuar si palë pa interes në këtë fazë të ri-vlerësimit dhe si pale që jeni pajtuar me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës Standarde për Eliminim të datës 02.04.2024.

E konfirmojmë se ju si OE vazhdimisht dhe vullnetarisht e keni vazhduar vlefshmërinë dhe sigurimin e ofertës dhe oferta juaj ka vlefshmëri dhe sigurim te vlefshëm deri me 09.01.2025, por duke marre parasysh vlerësimin e bere nga komisioni rivlerësues dhe faktin se herën e pare pas Kërkesës për Rishqyrtim ju nuk keni vazhduar me ankese ne OSHP, konsideroj se për këtë çështje mund te vendosi OSHP, me rastin e trajtimit te ankesave eventuale që mund te adresohen ne fazën e dyte te ankimimit.

Pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues në OSHP

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ada Consulting Group” SH.P.K Nr. 1186/2024 janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti kontraktues me date 21.11.2024 ka ngarkuar ne platformën e e-prokurimit “B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues” për herë të dyte pas ri-vlerësimit të ofertave sipas vendimit të PSH të OSHP-se, së bashku me “Letrat Standarde për tenderuesin e eliminuar dhe Suksesshëm” ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi me arsyetimin se: "në mungesë të ofertave të përgjegjshme, asnjë ofertë nuk plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit". Arsyet e eliminimit të grupit tone të operatorëve ekonomik sipas “Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar” është tërësisht e gabuar dhe keq aplikuar qëllimisht nga ana e autoritetit kontraktues kur njërin nga arsyet mundohet të konsideroj si ndryshim material, ndërsa arsyetimin tjetër, e përfshin në përfundimin e tërësisë së projektit, e jo të asaj që është kërkuar, “... të jenë kryer punime lidhur me X-Ray. Andaj, konsiderojmë se “vlerësimet” e këtyre kërkesave janë nxjerrë me konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, konstatime të cilat i kundërshtojmë në tërësi sepse ato janë në kundërshtim me edhe me vete arsyet e dhëna nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se në vendimin e tyre, si dhe në kundërshtim edhe me Konstatimet e Eksperteve shqyrtues në raportin e tyre. Arsyeya 1. -“Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - Garancioni i ofruar është me kushtëzim nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrahja financiare deri në 4 mil, jo siç është kërkuar i pakushtëzuar” Gjendja faktike është se në dosjen e tenderit tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” të nenit 8.1 & 8.2, ceket: Kërkesa 2. “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit)”

Dëshmia 2: “Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit). Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar (në rastin e kredisë së pakushtëzuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të projektit)”.

Faktet dhe Argumentet tona lidhur me këtë “arsyetim”, mbështeten në provat të cilat janë pjesë e ofertës së dorëzuar për këtë aktivitet të prokurimit, por që qëllimisht janë injoruar përsëri nga autoriteti kontraktues gjatë fazës së rivlerësimit të tenderëve duke shmangur edhe kërkesën dhe udhëzimin e OSHP-së, kur ka udhëzuar autoritetin kontraktues që bazuar në nenin 72 të kërkoj sqarimet e nevojshme për të siguruar po të njëjtën provë, siç e kishte siguruar Eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit të ankesës sonë të parashtruar në OSHP, ku ishte konstatuar se ajo plotëson qëllimin e kërkesës së autoritetit kontraktues, shih citatin nga vendimi i OSHP-se: në QKUK varësisht nga kërkesa e tij... ". Bazuar në përgjigjen e pranuar nga Procredit Bank me 13.08.2024 mendimi i ekspertit shqyrtues se dëshmia e ofruar nga OE ankues si e tillë plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar. Konstatimi dytë (H): Arsyeya e dytë e eliminimit të OE ankues, është se Konsiderojmë se “konstatimi” i autoritetit kontraktues se ne si Grup i OE nuk kemi përmbushur kërkesën e mësipërme (neni 8.1&8.2, kërkesa 2) me arsyetimin se kinse garancioni i ofruar nga banka limit kreditor të aprovuar në vlerë 4.000,000.00 euro" është i qëllimshëm, sepse nëse i referohemi edhe vet kërkesës së autoritetit kontraktues limitin e keni vendosur në se paku 4 milion, po aq sa është deklaruar nga vet Procredit Bank. Pyetja e parashtruar nga autoriteti kontraktues: Nëse

klienti juaj shpallet fitues dhe nënshkruan kontratën për projektin e përmendur, a mund të konfirmoni nëse banka juaj ofron garanci që kredia do t' i aprovohet klientit tuaj ne shume prej 4,000,000.00 €.

Përgjigjja e dhënë nga Procredit Bank: Sa i përket pyetjes suaj lidhur me klientin Ada Consulting Group SHPK, me këtë email ne ju vërtetojmë/konfirmojmë qe klienti Ada Consulting Group SHPK, ka limit kreditor te aprovuar ne vlere 4,000,000.00 Euro ne ProCredit Bank. Andaj, ne provoim se: Garancioni i ofruar sipas Letër Referencës dhe Deklarimet e bankës Procredit për OSHP por edhe për AK, dëshmojnë qartazi se plotësojmë në tërësi të gjitha kërkesat dhe nivelin e tyre të kërkuara nga autoriteti kontraktues, dhe nuk ka të bëjë ASPAK me ndonjë ndryshim material, siç provohet të shtrembërohet qëllimshëm nga autoriteti kontraktues (apo zyrtarët e caktuar nga autoriteti), sepse nuk prek asnjë element të kërkesave të dosjes së tenderit ose implementimin e kontratës qe do shkaktonte ndryshime materiale (Ju lutemi shihni standardin e dyfishtë që AK ne këtë aktivitet ka ndjekur lidhur me kuptimin e “ndryshim material”, kur në vlerësimin e parë rreth mosplotësimit të Formularit të Tenderit sipas Ankuesit 6.1-Afattit të Garacionit, ku 7 nga 8 OE duke vepruar ne kundërshtim me sqarimet e dhëna te datës 05.02.2024, edhe pse qartazi është ndryshim material, ata e ne Vendimin e dt. 15.04.2024 tek pretendimi i pestë, (vendim ky i anuluar nga OSHP), këtë e konsiderojnë si devijim të vogël).

Ligjërish ndryshim material ne këtë rast do të kishim vetëm nëse Banka me herët do të kishte lëshuar një Deklaratë e cila nuk e konfirmon mbështetjen e saj për ne si operator ekonomik, gjë që nuk e kemi ne rastin konkret, pasi që edhe po të shihet procesi ne kronologji, ne kemi një Deklaratë të Bankës e cila nuk ka ndryshim material, pasi që të njëjtën përgjigje e gjejmë edhe ne rastin kur Banka me dt. 13.08.2024 i ka kthyer përgjigjen duke i sqaruar Ekspertit Shqyrtues, se: “ Sa i përket pyetjes suaj lidhur me klientin Ada Consulting Group SHPK, me këtë email ne ju vërtetojmë /konfirmojmë që klienti Ada Consulting Group SHPK, ka limit kreditor të aprovuar ne vlere 4,000,000.00 Euro ne Procredit ku mbi bazën e kësaj përgjigje PSH i OSHP kishte aprovuar pretendimin tonë rreth kësaj çështje si të bazuar, ndërkohë që Banka të njëjtën e ka dhënë edhe ne përgjigje të Kërkesës për Sqarim. te dt. 17.10.2024 e parashtruar nga Zyrtari i Prokurimit Egzon Ukshini. ku i përgjigjet, citoj: “ Sa i përket pyetjes suaj lidhur me klientin Ada Consulting Group SHPK, me këtë email ne ju vërtetojmë/konfirmojmë që klienti Ada Consulting Group SHPK, ka kreditor të aprovuar ne vlere 4,000,000.00 EURO ne Procredit”. Pra shihet qartazi se konstatimi i AK se kinse ka ndryshim material ne këtë pikë, nuk qëndron dhe është tërësisht i pa bazuar, madje edhe tendencioz pasi që është një konstatim që tenton të rrëzoj edhe vendimmarrjen e organit përfundimtar ne një aktivitet prokurimi siç është vendimmarrja e OSHP-së lidhur me pikën konkrete. Për qëllime të mënyrës se si duhej të trajtohej kjo kërkesë, së bashku me dëshmitë e kërkuara, ne po citojmë shembullin e marr edhe nga Udhëzuesi Nr. 001/2023 për prokurimin publik, ku theksi bie mbi sqarimin “shënim premtues”.

Arsye 2. - “Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 mbi mundësinë teknike dhe/pse profesionale-Pas shqyrtimit te dëshmimeve te ofruara nga QKUK është evidentuar se pranimit teknik final është realizuar pas datës se hapjes se ofertave 27.02.2024. Kjo dëshmon se nuk është plotësuar kriteri për pranimit teknik te projektit para afatit te fundit te dorëzimit te ofertave dhe ky projekt është i pa pranueshëm sipas kërkesave te NJK dhe DT. Bazuar ne këtë fakt nuk mund te pranohen as dyert X-ray me hapje automatike si pjese e këtij projekti”. Sipas kërkesës se përcaktuar tek, Seksioni 11, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket: Kërkesa 2: “Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare

deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj. " Dëshmi 2: Një Listë të projekteve të realizuara - Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar.

Lista duhet t'i ketë këto të dhëna:

- Titulli kontratës
- Investitori
- Të dhënat e personit kontaktues,
- Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit,
- Vlerën e projektit.

Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura. Për çdo projekt të realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare).

Faktet dhe Argumentet, është fakt i patjetërsueshëm se autoriteti kontraktues qëllimisht ka konstatuar Përsëri gabimisht gjendjen faktike lidhur me dëshmitë tona të dorëzuara me tender lidhur me realizimin e punimeve për dyer X-Ray edhe gjatë fazës së rivlerësimit.

Deklarojmë se: Ada Consulting Group SHPK, ka paraqitur PROVA të mjaftueshme para AK, dhe

do të paraqes përmes kësaj ankese edhe para jush, për të vërtetuar se punimet e realizuara për X-Ray kanë përfunduar para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Me dëshmitë e listuara dhe bashkangjitura me këtë ankesë do shpjegojmë dhe dëshmojmë të kundërtën e asaj që autoriteti kontraktues, apo zyrtarë brenda autoritetit kontraktues, mundohen të paraqesin.

Kontratën e lidhur mes OE ACG-së dhe AK QKUK 09.07.2019. Kontratën si dëshmi po ngarkojmë për qëllime të shpjegimit dhe vërtetimit rreth mënyrës së trajtimit të çështjes së procedurave të pranimit të kontratave të punëve sipas nenit 33, e me specifikisht të paragrafit 33.3, shih më poshtë: Neni 33 Pranimit i përkohshëm 33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punë sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të kontraktuesin ose: a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzoj furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ar do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në dritën e fundit të asaj periudhe. Andaj, ndërlidhur me pikën e mëposhtme 10 "Rekomandim për pranim teknik përfundimtar - Ortopedia 29.11.2023)", vërtetohet se edhe tërë projekti (jo vetëm punimet për X-Ray) konsiderohet i pranuar më datën 27-30.12.2023 kur i referohemi datës së dorëzimit të "Kërkesës për Dorëzim të Projektit të datës 27.11.2023, pasi që neni 33 par 2 i Kontratës e përcakton në mënyrë taksative se AK ka qene i obliguar që jo me larg se 30 dite nga dita e rekomandimit të lëshoj certifikate për pranim ose refuzim të rekomandimit, gjë që në rastin konkret nuk e ka lëshuar, e që në kuptim të nenit 33 të kontratës, hyn në funksion edhe dispozita e nenit 100 të LPPA-së, i cili përcakton se: "7. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: "akti administrativ i miratuar në heshtje)".

02 Plani i menaxhimit të kontratës 25.08.2019. Përgatitur nga Menaxherja e Projektit QKUK, ku palët ishin pajtuar si më poshtë, citoj: 1. Duke u bazuar në kërkesën e AK (përfutesit-Klinika e Ortopedisë) punimet do të bëhen fillimisht në Objektin e ri-Klinika e ortopedisë, i cili objekt do të përfundohet në tersi do të behet pranimi teknik i objektit të ri-klinika e Ortopedisë, bartja e stafit nga objekti ekzistues i sallave të operacioneve si dhe funksionalizimi në tërësi.

2. Pas pranimit teknik të pjesshëm të objekti të ri-Klinika e Ortopedisë, do të filloj rrënimi dhe punimi i objektit tjetër". Pra kur autoriteti kontraktues ka konstatuar se citoj: për këtë projekt mungon pranimi teknik", ka dështuar që të vlerësoj se puna në këtë projekt ka qenë e organizuar në dy faza nga vetë autoriteti kontraktues. me qëllim të funksionimit të Objektit të Ri-Klinika e Ortopedisë, për çka në si kontraktor edhe e kemi bërë të mundshëm bazuar në PMK e dt.25.08.2019, dhe pikërisht për këtë arsye është konsideruar edhe pranimi i pjesshëm i tërësisë së projektit (por punimet për X-Ray kanë përfunduar para datës së publikimit të njoftimit për kontrate ku në punët e kryera dhe të pranuar hynë edhe pozicionet e kërkuara sipas FTD-së.

03_Pranimi teknik i fazës së parë Aneksi dt.06.02.2023. Ju lutem referohuni konstatimit të bere në shkresën e datës 06.02.2023 me numër të protokollit Nr. 1071. "Plotësim Ndryshim i Raporti/përparmin të pjesshëm të Ndërtesës së Sallave të Operacionit (aneksi) pjese e kontratës së lartcekur, që dështon se punimet kanë përfunduar dhe janë të pranueshme.

Konstatim pas vizitave dhe takimeve në teren. shqyrtimit të dokumentacionit të lartpërmendur dhe raporteve të organit mbikëqyrës, deklaratave të inxhinierëve dhe menaxherit të kontratës kemi verifikuar punët e realizuara dhe ndryshimet se këndejmi konstatojmë se punët ndërtimore të kryera në ndërtesën e Bllokut Operativ - Aneksi (J) janë realizuar sipas specifikave të kontratës dhe në aspektin cilësor janë teknikisht dhe vizuelisht të pranueshme. Për me tepër salla operative e Klinikës, objekt i ndërtimit të kësaj kontrate është në funksion para datës së publikimit të këtij tenderi/aktiviteti të prokurimit dhe si i tille është i pranuar dhe funksional, se përndryshe nuk mund të përdorej?! Pra tendenca që autoriteti kontraktues tenton ta ndërlidhë Objektin J me Objektin V nuk qëndron, pasi që edhe sipas PMK edhe sipas Raportit 06.02.2023 konstatohet në mënyrë taksative se dyert X-Ray janë të pranuar dhe janë lëshuar në punë, pas pranimit teknik të tyre.

Shih me poshtë kërkesën e ADA Consulting Group për pranim teknik, dhe rekomandimin e organit mbikëqyrës “Alb-Architect”:

4. Rekomandimi i Organit mbikëqyrës nga “Alb-Architect” të datës 05.07.2022

5. Kërkesa për pranim të pjesshëm të objektit punë kryesi Ada Consulting Group Sh-P.K

04 Minutat e Takimit SHSKUK Ortopedia 29.06.2022

Nga minutat e takimit të mbajtura mes palëve kontraktuese, mund të vëreni qartë se tashmë neve kishim hyrë në fazën përfundimtare të punimeve për këtë pjesë, që do shpinte tek konstatimi i shprehur me sipër nën pikën 03.

Konkluzion;

1. Te behën testimet e sistemeve dhe te dorëzohen para pranimi teknik raportet e testimit
2. Te behet Kërkesa zyrtare për pranim të pjesshëm për objektin A.

05 Rekomandim Pranimi Teknik i Punimeve të Kryera 05.07.2022

Nga shkresa e përgatitur nga kompania menaxhuese dhe mbikëqyrëse e projektit “ALB ARCHITECT” e kontraktuar nga QKUK i rekomandon zv. Menaxherit të Kontratës z. Bashkim Ibrahim, që QKUK të formoj komisionin për inspektim teknik të të punimeve të kryera për; bllokun operativ të Klinikës së Ortopedisë. Kjo dëshmon se punimet në bllokun e sallës operative të Klinikës së Ortopedisë kanë përfunduar dhe janë të gatshme për pranim. Ky raport në formatin Excel është ngarkuar për qëllim që më mënyrë vizuale të kuptoni dhe të dëshmohet se punimet në bllokun e sallës operative të Klinikës së Ortopedisë ishin afër përfundimit. Këto foto pasojnë minutat e takimit nën pikën 04 dhe ndërlihen me raportin e përshkruar nën pikën 05

07 Rekomandimi i Pranimi Teknik xRay 06.07.2022.

Nga shkresa e përgatitur nga kompania menaxhuese dhe mbikëqyrëse e projektit vi “Alb Architect” e kontraktuar nga QKUK, i rekomandon zv. Menaxheri të Kontratës z. Bashkim Ibrahim, që QKUK duhet të paiset me certifikatën për mbrojtjen nga rrezet X, për sallat e operacionit nga Autoriteti Përgjegjës për këtë lloj të aktivitetit. Kjo dëshmon se punimet në bllokun e sallës operative të Klinikës së ortopedisë kanë përfunduar tashmë, dhe se autoriteti kontraktues, QKUK duhet të aplikoj për certifikim tek autoriteti përkatës shtetëror.

Nga minutat e takimi të mbajtura mes palëve kontraktuese, mund të vëreni qartë se tashmë se kjo pjesë ishte në funksion dhe ishte nën garancion. Kjo dëshmon shumë qartë se punimet kanë përfunduar kohë më parë. Diskutime të përgjithshme në lidhje me funksionimin e pjesës së objektit

që tashmë është në funksion si dhe për ecurinë e punimeve në demolimin e pjesës së vjetër. Duke ju referuar pikës 08 më sipër dhe diskutimeve të përfshira aty, shihet se nga kontraktori kërkohet të ndërhyhet në rregullimin e dyerve automatike për shkak të telasheve në funksionim. Me datën 07.03.2023 kontraktori ADA njofton QKUK-në për hapat e ndërmarr si dhe arsyet që po vije deri tek mos funksionimi i dyerve, nga keq operimi i stafit të QKUK-së. Kjo përsëri dëshmon se pranimi teknik i këtyre punimeve ka përfunduar moti dhe ka qenë në funksion dhe nën periudhë

garantuese. për çka OE Ada Consulting Group ne kuadër te garancionit ka ndërhyrë ne rregullimin e tyre pasi që për shkak të përdorimit jo adekuat (përdorimi i hapjes me forcë fizike) nga stafi i QKUK-Ortopedi, ato kishin dale nga sistemi i funksionit. Nga kjo kërkesë shihet qartazi se Ada Consulting Group SHPK, kishte dorëzuar kërkesën për pranim përfundimtar teknik te projekti ne tërësi, pasi që kishte përfunduar të gjitha punimet sipas projektit “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ...”, duke kërkuar edhe caktimin e datës për inspektim final dhe dorëzimin e dokumentacionit të kompletuar për pranim teknik.

Duke u nisur nga përshkrimi i këtij raporti mund të konstatohet se organi menaxhues dhe mbikëqyrës ALBARCHITEC, i kontraktuar nga QKUK. bën rekomandimin e pranimit teknik te punëve, dhe kjo vije pas kërkesës së datës 27.11.2023 bërë nga punë kryesi ADA Consulting Group. Kjo është edhe një dëshmi shtesë që ndërlidhet me faktin se punimet kanë përfunduar para

datës që autoriteti kontraktues pretendon e që është data 31.05.2024, datë kur është protokolluar raporti. Por ligjërisht projekti është pranuar më datën 27-30.12.2023.

12 Raporti Përfundimtar i Menaxheres se Kontratës, dt.29.11.2023

Me datë 29.11.2023 Menaxherja e Kontratës, znj. Donjeta Berisha, harton Raportin Përfundimtar të cilin ja drejton z. Nexhat Halili, Shef i Prokurimit ne QKUK, i cili protokollohet me nr.343 dt. 16.01.2024, dhe me të cilin e njofton me gjithë ecurinë e procesit të punimeve dhe kryejn e të gjitha punëve nga operatori ekonomik ne pajtim me paramasat dhe paralogarite te skicave te projektit sipas kontratës se nënshkruar.

13 Pranimi Teknik i fazës se dytë Aneksi “V”. dt.31.05.2024

Duke u nisur nga leximi i këtij raporti, sidomos pikave 4 dhe 5 si më poshtë, dhe nëse i referohemi nenit 33.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës konstatohet se i tërë projekti është pranuar më datën 27-30.12.2023. Nëse shikohet me kujdes “Raporti për kontroll teknike të pjesës së dytë të ndërtesës se sallave të operacionit (Aneksi V) pjese e kontratës se lartcekur” i dt. 31.05.2024, shihet qartazi se nuk kemi të bëjmë me pranim përfundimtar të projektit ashtu siç konstaton Komisioni i Vlerësimit me rastin e dërgimit të Letrës Standarde-B42, por e vërteta qëndron ne faktin se kemi të bëjmë me pranim te Objektit “V”, i cili ne bazë të PMK është objekt i ndarë nga “Objekti J” ne të cilin janë të vendosura dyert X-Ray.

Ajo çfarë pasqyrohet në Raportin e dt.3 1.05.2024, është fakti se kemi të bëjmë me pranim të punëve të kryera që nuk përkojnë fare me pozicionet e “Situacionit 3” të pranuar sipas “Raportit për kontroll teknike të pjesës së parë të ndërtesës se sallave të operacionit (Aneksi J) pjese e kontratës se lartcekur” i dt.06.02.2023 (ku ishin pranuar dyert X-ray) pasi që siç e theksuam Objekti “V” ka qenë i ndarë me PMK, dhe pranimi i tij është bërë jo si pranim i tërësishëm dhe përfundimtar siç konstaton AK, por si pranim i pjesës së dytë të ndërtesës.

Pas vizitave dhe (ankimeve në teren, shytimit të dokumentacionit të lartpërmendur dhe raporteve

Operatorit mbikëqyrës, deklaratave të inxhinierëve dhe menaxherit të kontratës kemi verifikuar punët e realizuara dhe ndryshimet. Së këndejmi konstatojmë se punimet ndërtimore të kryera në ndërtesë Aneksi (V), objekti mund te përdorur. Komisioni rekomandon të vazhdohet me procedura e mëtutjeshme. Andaj edhe të gjitha këto përshkrime, ne mënyrë të qartë dhe shumë të argumentuar hedhin poshtë “argumentin” e Komisionit të Vlerësimit të AK, se punimet kanë

përfunduar pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë (përderisa në “Letrat standarde..” jeni shprehur gabimisht “deri në datën e mbylljes..”)

Duke pare se autoriteti kontraktues ne mënyrë te vazhdueshme insiston ne një qëndrim te pa baze se punimet nuk kane përfunduar, neve si grup i operatoreve ekonomik jemi detyruar qe për hire te saktësisë te kërkojmë nga QKUK, gjegjësisht ekipi menaxhues i kontratës/projektit te konfirmojnë me data përfundimin e punimeve te përshkruar ne këtë kërkesë. Shih kërkesën dërguar QKUK, ekipit menaxhues te projektit/kontratës.

Ne përgjigje te saj përmes e-mailit menaxheria e kontratës konfirmon te gjitha ato qe neve kemi dorëzuar me oferte, me sqarimet dhe dëshmitë e dorëzuara me këtë kërkesë për rishqyrtim. Andaj besojmë fuqishëm se AK nuk duhej të kishte asnjë hezitim se punimet kane përfunduar shume kohe me pare. Shih e-mailin e dërguar si dhe shkresën e bashkangjitur.

Argumente shtesë të patjetërsueshme: Vet konstatimi si pjesërisht i bazuar nga ekspertet shqyrtues, citati: “Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar ”, dëshmon se pretendimi qëndron, por nuk kanë krejtësisht të qartë brengjen e autoritetit kontraktues?!

Autoritet kontraktues por edhe zyrtar përgjegjës e konfirmojnë se punimet që ka të beje me sallën operative të Klinikës së Ortopedisë, Faza e Parë, se këto punime kanë përfunduar. Kjo është e cekur në e-mail për sqarime dërguar tek QKUK ku shpreheni: “Sipas dëshmive shihet se projekti është i ndare ne dy pjese dhe është pranuar vetëm.

Pjesa e pare “Siç shihet nga pyetja e parashtruar Procredit Bank-ës, len përshtypjen se veçse ka pasur një vendim lidhur me plotësimin e kërkesave lidhur me përfundimin e punimeve për X-Ray, por si duket përgjigjja e dhënë nga Procredit Bank, Autoritetin Kontraktues e ka zënë në befasi, dhe atëherë shihet qartazi se kanë qenë të shtyrë që të “gjejnë” me çdo kusht një argument shtesë për eliminimin e kompanisë sonë, dhe anulimin e tërë aktivitetit të prokurimit.

“Nëse klienti juaj shpallet fitues dhe nënshkruan kontratën për projektin e përmendur, a mund të konfirmoni nëse banka juaj ofron garanci që kredia do t i aprovohet klientit tuaj ne shume prej 4,000,000.00 €? ”

Për qartësi dhe kuptim me te qarte te termeve te përdoruara nga autoriteti kontraktues ne dosje te tenderin, specifikisht tek “Kërkesat Teknike Profesionale”, siç është termi i përdorur “Procesverbal i Pranimit teknik “ dhe termi “Pranimi i Përkohshëm” sipas nenit 33 te Kushte te Përgjithshme te Kontratës, neve e shohim te domosdoshme te japim sqarimin e nevojshëm te dallimit kuptimor mes këtyre dy termave: Në kontekstin e kontratave të punës, "Pranimi teknik" dhe "Pranimi i përkohshëm" janë dy faza të dallueshme në procesin e pranimit të projektit: Pranimi teknik: Kjo fazë përfshin inspektimin dhe testimin e materialeve dhe të punës për tu siguruar që ato të përmbushin standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në kontratë. Është një hap paraprak ku fokusi është në verifikimin e aspekteve teknike të punës, të tilla si cilësia, siguria dhe respektimi i specifikimeve teknike.

Pranimi i përkohshmen. Pranimi i përkohshëm është një pranim i kushtëzuar që tregon se projekti është përfunduar në një nivel të kënaqshëm, por performanca duhet të verifikohet në kushte operationale brenda një periudhe të rënë dakord.

II. Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit sipas nenit 62 të ligjit. Duke e konsideruar veten si grup i operatorëve ekonomik të përgjegjshme nga ato që kemi dëshmuar më sipër, konsiderojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62. [Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit] Çdo tentim për të injoruar të gjitha këto prova/dëshmi, besojmë se është i qëllimshëm dhe ne mbrojtje të se keqes dhe jo ligjore. Andaj, çdo tentim nga kushdo që të konsideroj si ndryshim material, ose jo plotësim i kërkesës, nga ne do konsiderohet se është një veprim i qëllimshëm për dëmtimin e kompanisë sonë, e që sa për informim, veprime të tilla të qëllimshme për të shkaktuar dëm palëve tjera, tejkalojnë procedurën administrative të zhvilluar për një aktivitet të prokurimit publik, duke hyrë edhe në fushën penale, dhe që për bindjen tonë si OE i përgjegjshëm, i eliminuar në mënyrë të kundërligjshme. Jemi të detyruar që përveç mjeteve juridike të garantuara me dispozitat e LPP-së, në një mënyrë edhe përkundër vullnetit tonë, të vlerësojmë edhe mundësinë e hapjes së një procedure penale ndaj vendimmarrësve në AK, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, krejt kjo me qëllim që shkelësit e ligjit të mos mbetën pa u ndëshkuar, duke u amnistuar për shkeljet ligjore vetëm me një anulim të vendimmarrjes së tyre nga organi përfundimtar në procedurën e vendimmarrjes sipas LPP-së, respektivisht anulimin e vendimmarrjes nga OSHP.

III. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve sipas neni 108/A të ligjit

Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës sonë për ri-shqyrtim të bërë me datën 25.11.2024. Autoriteti kontraktues, gjegjësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duke vepruar në këtë mënyrë ka bërë shkelje të rëndë siç parashihet me nenin 97 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, kur kihet parasysh kërkesat/obligimet ligjore, shih citatin: "6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë c/he dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) c/të shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë."

Zyrtari përgjegjës i prokurimit, me datën 03.12.2024 mundohet të arsyetohet me gjëra që nuk kanë të bëjnë aspak me këtë aktivitet, duke harruar faktin se herën e parë të shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim pasur kohë.

Kërkesë për Organin Shqyrtues të Prokurimit: Andaj në ndërlidhje me këto veprime, parashitjmë kërkesë që Organi Shqyrtues i Prokurimit, bazuar në nenin 91 të Rregullores të inicioj revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit, sepse Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, është në shkelje të rënda të ligjit sipas nenit 97 (Shkeljet e rënda), paragrafi 1 Rregullores.

Përmbledhje e Shkeljeve: Duke u nisura nga sa është deklaruar më sipër në këtë dokument lidhur me shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues, me poshtë në pika të përmbledhura janë paraqitur këto shkelje: Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të Ligjit dhe nenit 40 të rregullores, duke mos vlerësuar ofertat/tenderët e operatorëve ekonomik në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 64 të ligjit, si dokument mbizotërues, ku vendos kufizime dhe keq interpretuar lidhur me dorëzimin e dëshmive që kanë të bëjnë me kërkesat e përzgjedhjes të vendosura në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 62 të LPP-së, kur dihet se ka operatorë ekonomik të përgjegjshëm që kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit. Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP, në momentin që nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesave për ri-shqyrtim të bëra nga operatorët ekonomik brenda afatit

ligjore 3+3 ditë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AK Invest Dooel Tetovo & Hidro Project SH.P.K” Nr. 1191/2024 janë parashtruar si në vijim:

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ankesë: Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: Sa i përket Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm-eliminuar) nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit dhe Njoftimit te Vendimit te AK për anulimin e tërësishëm të aktivitetit të Prokurimit të datë 21.11.2024. AK, qëllimshëm dhe ne kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 51, paragrafit 1 dhe 2 të LPP-së, eliminon ofertën tonë, duke shkelur kërkesat e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT.

Pretendimi i parë: Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit për Kërkesën 2 në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, ku edhe pas ri-vlerësimit të Ofertave dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së 0362/2024, AK po me te nijetin avaz arsyetohet si ne vijim: (Shiko foto nr 1 ne aneksin e bashkangjitur) Arsyetimi i AK është i pa qëndrueshëm dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura, për shkak se ka bërë tejkallim të Kompetencave dhe autorizime, për me tepër shih arsyetimin e AK, ku ende nuk e ka të qartë kërkesën e përzgjedhjes të paraparë vet nga AK në NJK dhe DT, shih faktet e rastit: Faktet e rastit: Kërkesa: 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit). Dëshmia: 2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit). Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar (në rastin e kredisë se pakushtëzuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të projektit). Pra, ne rastin konkret, AK në DT, të kriteret e përzgjedhjes ka kërkuar kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare - qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro, kurse, ne kemi ofruar mbështetje financiare nga banka Haklbanke, në shume prej 2 milion euro, mbështetje nga SPARKASSE, në shume prej 1 milion e 250 mije euro dhe mbështetje nga STOPANSKA BANKA AD, në shumë prej 2 milion euro, të tyri bankat me seli ne Maqedoninë e Veriut. Dhe, rrjedhimisht konsorciumi ynë i plotëson në tersi kërkesat e AK të parapara në NJK dhe DT.

Pra, AK edhe ne fazën e ri-vlerësimit, tejkallon kompetencat dhe autorizimet, sepse AK, nuk mund të trajtoj të papërgjegjshëm konsorciumin tonë për shkak të pa përgjegjësisë dhe sjelljeve jo profesionale të zyrtareve përgjegjës të AK, për faktin se zyrtaret përgjegjës të AK nuk i kanë të qarta kërkesat në lidhje me “mbështetje financiare” dhe “garanci bankare”, ngase këto dy dokumente kanë dallime, shih sqarimin: Letër mbështetja nuk është Garancion dhe nuk e luan rolin e garancionit, letër mbështetja konfirmohet nga banka, qe, nëse klienti i tij shpallet fitues ai do te ketë qasje ne produkte dhe linjate ndryshme bankare për t’i ndihmuar ne financimin e punëve (qofte kapitale apo shpenzime) gjithmonë sipas kushteve te bankës.

Për dallim nga letër mbështetja, Garancioni është Instrument financiar, i cili kërkohet nga ofertuesit te ofrohet ne formë të sigurimit të ofertës (nga banka apo nga kompania e sigurimeve) qe zakonisht janë ne “Thirrje te pare, te pakthyeshme dhe te pakushtëzuara”. Ky dokument është “Garancion” për sigurim të ofertës ose sigurim i performances i cili kërkohet vetëm nga fituesi

i tenderit. Për me tepër shih, përkthimin ne origjinal të letër mbështetjes nga SPARKASSE, me I milion e 250 mijë euro dhe nga STOPANSKA BANKA AD, 2 milion euro. Sipas letër mbështetjes që kemi lëshuar me kërkesë të klientit tone “AK Invest”, ju informojmë se linja kreditore e aprovuar përbehet prej disa produkteve duke përfshirë linjën për garancinë. Për momentin linja është e gatshme dhe mund të shfrytëzohet ne pajtim me kushtet e aprovuara.

Duke marr parasysh raportin e gjatë dhe të suksesshëm me “AK Invest” ne konfirmojmë gatishmërinë tone për të përkrahur ne çdo projekt ne te ardhmen dhe për të rritur limitet ne pajtim me kushtet e politikave të biznesit dhe rregulloret ligjore. Pra, nga sqarimet e lartë cekura, letër mbështetja nuk është garanci bankare siç arsyetohet AK në eliminim e që arsyetimi i AK është kundërshtim të plotë me frymën dhe qëllimin e LPP-se, ngase shkel dispozitat e nenit 51, paragrafit 1 dhe 2 të LPP-së, duke aplikuar kritere shtese të pa parapara në NJK dhe DT.

AK, në thirrje tërësisht të gabuar të nenit 59 të LPP-se, se kinse, nuk kemi pranuar sqarime shtese nga Bankat e lartë cekura ne afatin e caktuar, kur dihet se sqarimet nga Institucionet Financiare, kërkojnë me shume kohe, e që AK ka bërë veprim të ngutshëm kur eliminon ofertën tone edhe pse ka pranuar konfirmimin nga banka. Sepse AK është njoftuar nga banka me konfirmim të ri- përsëritur se nëse OE, e nënshkruan kontratën, mbështetja e bankës do të jete e pakufizuar sipas letrës mbështetës për me shume shih emalin e bankës drejtuar personit të AK z. Berat Murmullaku.

Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme ose keni nevojë për informacion shtesë, mos ngurroni të na kontaktoni. Po ashtu edhe pas ri-vlerësimit të Ofertave, AK eliminon ofertën tonë pa drejtësisht nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se “kontrata është e pa pranueshme për AK” dhe në kundërshtim të plotë me vendimin e OSHP-se, nr.0362/2024, rasti i njëjtë dhe palët e njëjta, ku me këtë vendim i kërkohet AK të kërkojë sqarime shtese sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-se, ne lidhje me “kontratat e noterizuar” gjë që AK nuk e ka marrë fare në konsideratë vendimin e OSHP-se, shih, vendimin e OSHP-se, faqe 23, pjesa e parë. Për me tepër edhe ne këtë rast, AK tejkalon kompetencat dhe autorizimet ligjore sepse nuk mund të diskualifikoj një tenderues për kërkesa/kritere të pa parapara në NJK dhe DT, për faktin se po t'i referohemi kërkesës së AK, nuk është kërkuar që kontrata duhet të prezantohet të noterit në formatin origjinal, por është kontratë e noterizuar, gjë që, sipas kërkesave të AK, kontrata për inxhinierin ne fjalë është në përputhje të plotë me kërkesat e AK. Po ashtu edhe për inxhinierin e Operatives, të Ndërtimtarisë, të Hidroteknikës, të Elektros, të Makinerisë, të Gjeodezisë dhe eksperti për siguri dhe shëndet në punë, të gjitha kontratat janë në përputhje të plotë me kërkesat e AK sepse të gjitha janë të noterizuar. Prandaj, janë të pa pranueshme, të pa drejta, të qëllimshme dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura, pretendimet e AK për të eliminuar konsorciumin tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit, për faktin se, tani ne këtë fazë ri-vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve aplikon prapë kritere shtese të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT. Për me tepër, referuar paragrafit 3 të nenit 7 të LPP-se, çdo AK i ndalohet shprehimisht çdo shmangie nga termat dhe kriteret e precizuara në DT dhe devijimi eventual atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP-së. Prandaj, duke u bazuar ne pretendimet tona të argumentuara dhe ne mbështetje ligjore, AK pa drejtësisht dhe ne mënyre tendencioze eliminon ofertën tone nga aktiviteti i prokurimit edhe pse jemi të përgjegjshëm sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar çmimin me te ulet sipas kriterëve për dhënie të kontratës.

Pretendimi i tretë: Njoftimi i Vendimit të AK për anulimin e tërësishëm të aktivitetit të prokurimit, të dt. 21.11.2024. Vendimi i AK për anulimin e Aktivitetit të Prokurimit bie ndesh edhe me dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht nenin 62, sepse dispozitat ligjore përcaktojnë se në cilat raste dhe në cilat situata duhet të anulohet një tender.

Ne vijim citojmë dispozitat e LPP-se, nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit:

I. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

II. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve. Nëse referohemi në dispozitat ligjore të LPP-se, AK nuk ka të drejtë të Anuloj në tersi aktivitetin e Prokurimit, kur ka operator të përgjegjshëm siç jemi në GOE “AK Invest Dooel” Tetovë dhe “Hidro Project” shpk.

Në as një nga dispozitat e këtij ligji nuk e parashohin një situatë të tillë të anulimit të aktivitetit të prokurimit, për faktin se provat e dëshmuara me rastin e dorëzimit të tenderit e vërtetojnë se jemi në përputhje të plote me kërkesat e AK. Prandaj, bazuar në dispozitat ligjore të parapara në LPP, AK nuk mund të anulohet aktivitetin e prokurimit kur ka OE të përgjegjshëm dhe brenda buxhetit të AK. Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me të ulët, madje, nuk kemi pranuar vendim për aprovim apo refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga AK, atëherë, kërkojmë nga OS14P-ja, që ankesën të trajtoj me pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-se, njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit, vendimit të OShP-se nr.0362/2024, interpretimit të KRPP-se.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt & Imk -Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.” Nr. 1200/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: Shkelja e pare ligjore ka të beje me faktin se grupi i OE-ve ankues, me datën 26.11.2024, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, ka prezantuar prova fakte dëshmi për rivlerësim të kundërligjshëm dhe anulim të procedurës së prokurimit kundërligjshëm, pavarësisht kësaj AK – Ministria e Shëndetësisë, zyra e Prokurimit me datën 09.12.2024, me vendim Refuzon përmes vendimit të përbashkët edhe ankesën tone ku në faqen 33, potencohet se edhe pas sqarimeve në proces ri vlerësimi plani dinamik ka mospërputhje edhe në përmbajtje!

AK- MSH, këtë pohim nuk e argumenton se për çfarë përmbajtje behet fjale apo edhe cili nga elementet ne plan dinamik mungon. Me nenin 108/A te LPP-se gjegjësisht me paragrafin 8, pika 4 përcakton: Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:

8.4 Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi. AK – MSH, ne Arsytim te vendimit te eliminimit nuk e ka shqyrtuar vendimin e saje ne kuptim te asaj qe është kërkuar nga ankuesi, përkatësisht arsyetimi se ka “mos përputhje ne përmbajtje” nuk është trajtim apo arsyetim për eliminim te ofertës apo edhe anulim te tërësishëm te procedurës.

Ngjashëm është vepruar edhe me afatet ligjore, është konsumuar shkelje bazike, përkatësisht

kërkesa jone është ngarkuar ne platformën e-prokurimi me datën 26.11.2024, ndërsa vendimi – refuzimin e kërkesës ne procedure te ri shqyrtimit e kemi pranuar me datën 09.12.2024.

Ky veprim apo mos veprim është i përcaktuar me nenin 108/A, te LPP-se gjegjësisht paragrafin 6. Par 6, neni 108/A, përcakton: “Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë”. AK – MSH, për te vlerësuar pretendimet tona ankimore, gjegjësisht për te përshkruar fjalinë “mospërputhje ne përmbajtje”, i janë dashur plote 15 dite!

Pretendimi ankimore 2: Shkelja tjetër ligjore e Autoriteti Kontraktues -MSH, në procedurën e ri vlerësimit të ofertave përsëri ka të bëjë me pa përgjegjësinë e zyrtarëve përgjegjës të prokurimit dhe anëtarëve të komisionit ri vlerësues të ofertave, pasi që Organi Shqyrtues i Prokurimit, përkatësisht Paneli Shqyrtues, më datën 11.09.2024, ka nxjerrë vendim ndaj kësaj procedure të prokurimit, ku në pikën 3, të vendimit, Autoritet Kontraktues- MSH, është obliguar që në afatin prej 10 ditësh t’i ndërmerrni të gjitha veprimet lidhur me aktivitetin e prokurimit, ndërsa më datën

21.11.2024, ka publikuar vendimin mbi rezultatin e rivlerësimit dhe tani tentoni ta anuloni procedurën e prokurimit kundërligjshëm. Me nenin 59, të LPP-së është e përcaktuar periudha kohore e vlerësimit të ofertave, përkatësisht me nenin 40, paragrafi 3, të Rregullores me nr. 001/2022, qartë përcaktohet që: “Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më

të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave...” Ndërsa Autoritet Kontraktues - MSH, për të ri vlerësuar procedurën e prokurimit i’u janë dashur mbi 70 ditë kalendarike. Të gjitha këto veprime përkatësisht mos veprime bien mbi barrën tuaj si Autoritet Kontraktues dhe zyrtareve tuaj përgjegjës në zyrën e prokurimit, ku neglizhenca dhe prolongimi i procedurës ka kosto ndaj tërë grupit të OE-ve që nga validiteti i ofertave, sigurimi i tenderit, paisjet teknike dhe kapacitetet tjera të burimeve njerëzore kanë kosto dhe në procedurë eventuale në si grup i kompanive si tërësi detyrohemi të kërkojmë kompensimin e dëmeve te shkaktuara dhe jo vetëm. Kjo çështje është konfirmuar edhe nga vet AK – MSH, ne vendimin e saje te datës 09.12.2024.

Pretendimi ankimor 3: Sa i përket arsytimit të parë të eliminimit, lidhur me planin dinamik dhe se grupi i Operatorëve Ekonomik ankues, nuk e ka plotësuar si duhet apo dhe nuk është plotësuar nga forma standarde e dosjes së tenderit, tregon qartë për mos përgjegjësi institucionale, shkelje

te parimeve dhe dispozitave ligjore për Prokurim Publik në fuqi. Si fillim në si grup i OE-ve ka dhënë përgjigje të detajuara ndaj kërkesës për sqarim lidhur me planin dinamik të prezantuar në ofertë. Plani dinamik është i krijuar përmes programit përkatës “Ms Project”, program ky i krijuar pikërisht për këtë çështje që ka të bëjnë me projekte inxhinierike, ku përfshinë me saktësi të gjitha hapat dhe veprimet e realizimit të punëve. Plani dinamik i dorëzuar në ofertë i përmban të gjitha elementet, numrin e ditëve dhe të gjitha veprimet tjera që nga fillimi i realizimit të projektit deri në përmbylljen e tij. Sa i përket pozicionit H.4, tani të përshkruar, nuk është asgjë tjetër por vetëm tentativë për të eliminuar kundërligjshëm ofertën tonë. Në si kompani edhe ndaj letrës standarde – kërkesës për sqarimin e tenderit të aplikuar përgjatë ri vlerësimit të ofertave, kemi dhënë sqarime të detajuara, gjegjësisht realizimi i këtij pozicioni është planifikuar të realizohet përmes realizimit të pozicioneve që kanë të bëjnë me instalimet e pozicionit H – hidronistalimet dhe ky arsyetim në asnjë rrethanë nuk mundë ta eliminoi kompaninë tone si të pa përgjegjshme.

Për më tepër kompani tjera pjesëmarrëse pikërisht në këtë procedurë të prokurimit shumë nga pozicionet dhe veprimet përgjatë realizimit të punëve nuk i kanë të përfshira por të njëjtat për këtë çështje nuk janë të eliminuara.

Përveç kësaj, si rezultat i neglizhencës së zyrtareve përgjegjës të prokurimit, prolongimit të procedurës së prokurimit dhe veprimeve tjera kundërligjore të konsumuara nga Autoriteti Kontraktues – MSH, tani më i njëjti plan dinamik, nuk mundë të jetë si plan i zbatueshëm, meqë kthimi prapa në kohe është i pa mundur dhe detyrimisht duhet të krijohet plan i ri, para nënshkrimit eventual të kontratës dhe se grupi i Operatorëve Ekonomik, ankues me përgjegjësi të plotë ligjore dhe profesionale do t'i përmbahet periudhës kohore të dhënë në planin dinamik të ofruar me ofertë.

Përveç kësaj me vendimin e OSHP-së, të datës 11.09.2024, me nr. 2024/0362, tek arsytimi i të njëjtit qartë trajtohet çështja e planit dinamik të kontestuar nga ne në vlerësim fillestar të ofertave dhe është konstatuar: “Lidhur me planin dinamik të OE ankues ”Mabco Constrection” paneli shqyrtues vlerëson se duke qenë se nuk ka legjislacion në fuqi në fushën e ndërtimit në Kosovë, dhe nuk është vërtetuar mjaftueshëm se a është apo jo plani dinamik i ofruar nga OE në harmoni me dosjen e tenderit, paneli shqyrtues vlerëson se AK duhet të kërkojë gjatë rivlerësimit sqarime shtesë nga OE për planin e ofruar”.

Pra çështja e planit dinamik është trajtuar me vendim të organit kompetent, është potencuar se nuk ka legjislacion në fuqi në fushën e ndërtimit në Kosove, sa i përket planit dinamik dhe Autoriteti Kontraktues, duhet të kërkojë gjatë ri vlerësimit sqarime shtesë lidhur me planin dinamik. Në si grup i OE-ve kemi ofruar sqarime konkrete lidhur me planin dinamik përderisa juve si Autoritet Kontraktues, në mënyrë kundërligjore tentoni të anuloni procedurën e prokurimit pavarësisht se ne si Operator Ekonomik, kemi ofertuar si të përgjegjshëm në të gjitha aspektet.

Edhe në procesin paraprak të kontestimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, ne si kompani kemi sqaruar që me ligj për Prokurim Publik në fuqi dhe rregulla tjera të ndërtimit qëllimi i planit dinamik është përfundimi në afatin e përcaktuar të aktivitetit punës. Plani dinamik i

prezantuar nga grupi i OE-ve, ankues në ofertë, ka të përshkruara të gjitha fazat e realizimit të punës dhe sipas afatit të përcaktuar nga AK – Ministria e Shëndetësisë. Rrjedhimisht, mos aplikimi i formës së Autoriteti Kontraktues – MSH, nuk e bënë ofertën e pa përgjegjshme, përkatësisht, paragrafi. 3 i nenit 44 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, nuk është obliguese për kompanitë. Forma standarde ka për qëllim ti ndihmoj kompanitë ofertuese vetëm për përgatitjen e ofertave.

Par. 3 i nenit 44 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik parasheh qe: “Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.” Pra sipas dispozitës se sipër përshkruar forma standarde ka për qëllim të ndihmoj operatorin ekonomik dhe nuk ka për qëllim të obligoi, që të përdor të njëjtën. Sa i përket aplikimit të formës standarde lidhur me planin dinamik të realizimit të punëve, ekzistojnë edhe vendime të OSHP-së si dhe interpretime të KRPP-se. Madje lidhur me planin dinamik pikërisht Autoritet Kontraktues – MSH, gjegjësisht zyrtare përgjegjës të prokurimit si dhe anëtarë të njëjtë të komisionit vlerësues apo ri vlerësues, për kompani tjera në procedura tjera keni gjykuar ndryshe, pavarësisht se kompanitë nuk kanë aplikuar format standarde, ju si AK i keni kualifikuar si të përgjegjshme. Shembull konkret për procedurën e prokurimit të inicuar nga ju si AK – MSH “Ndërtimi i QKMF Drenas”, me nr prok: 206-23-6378-5-1-2, pavarësisht kërkesës se AK-se, për plan dinamik të kërkuar me formë standarde si në këtë rast, kompania “AC Ing” shpk, është kualifikuar si kompani e përgjegjshme dhe për këtë ekzistojnë dëshmitë e ngarkuara në platformën e-prokurimi !

Prove: Procedura e sipër përshkruar ofertat dhe dëshmitë i gjeni ne platformën e-prokurimi. Me ligj për prokurim Publik, parimi i konsistencës, i pa anshmërisë, gjegjësisht mos trajtimi i barabarte i Operatoreve Ekonomik, pavarësisht procedurave të prokurimit, mos respektimi i vendimit te OSHP-se dhe anulimi i aktivitetit te prokurimit në kundërshtim me nenin 62, te LPP-se, konsiderohen si shkelje të rënda të ligjit për Prokurim Publik. Neni 97, i Rregullores me nr 001/2022, për PP, par.1, pika d), h) dhe k), përcaktojnë:

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë,... trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njësisë së kërkesës.

h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së

k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sa i përket planit dinamik, në raportin e ekspertizës të datës 23.05.2024, me nr. 2024/0352, të

nxjerre nga znj. Rexhepi, qartë është potencuar se: “ Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk mund te eliminohet një OE me arsyetimin se nuk e ka përdorur formatins standard te publikuar nga AK-se, e rëndësishme është qe plani ti përmbajë elementet e duhura ashtu siç kërkohet...”, si rrjedhojë AK – MSH, nuk është konsistente ndaj vlerësimeve të saja dhe nga zyrtaret përgjegjës të prokurimit përkatësisht nuk janë zbatuar vlerësimet dhe rekomandimet e instancave kompetente në zbatim të ligjit për Prokurim Publik.

Pretendimi ankimor 4: Sa i përket arsytimit të dytë të eliminimit ku është potencuar se anëtari i grupit IMK, nuk ka prezantuar ISO certifikatat. Ne si grup i OE-ve, edhe në kërkesën paraprake për ri shqyrtim, qartë kemi potencuar se ISO certifikatat janë kërkuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, rrjedhimisht me dispozitat ligjore të LPP-së në fuqi, të njëjtat kërkesa si burim ligjore kanë dispozitat nga neni 69 i Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht, kërkesat e tilla

sipas paragrafit 4 të nenit 71, nuk janë obligative për secilin anëtar veç e veç. Përkundër këtij fakti në kërkesën paraprake për ri shqyrtim përfshirë edhe ankesën e deponuar në OSHP, kemi prezantuar dëshmitë lidhur me ISO certifikatat e anëtarit të grupit IMK Industria Metalike e Kosovës shpk.

Neni 71, i LPP-se, përcakton: “Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij

ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.”.

Bazuar në dispozitën e lartpërmendur, për të eliminuar ofertën tone si të papërgjegjshme me të njëjtin arsyetim, të njëjtat certifikime AK- MSH, ka qene dashur t’i aplikoni te kërkesat e përshtatshëmërisë profesionale dhe jo te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. Pavarësisht kësaj grupi i OE-ve ankues në oferte ka prezantuar certifikime ekuivalente, dhe atë certifikatat: EN 1090 – 2; ISO 3834 – 2; ISO 9606 – 2; ISO 9712 – 2 dhe ISO 1473-2.

Neni 70 i Ligjit për Prokurim Publik shprehimisht përcakton që: “Po që se AK kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura, me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit të OE-se me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, AK do të referohet standardeve që bazohen në standarde vendore, evropiane apo ndërkombëtare. AK do t’i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ i certifikuar e barasvlershme, pavarësisht nga vendi...”. ISO certifikatat e përshkruara si me sipër janë ekuivalente dhe të barasvlefshme me ato të aplikuar nga AK – MSH, në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontrate. Për më tepër, AK- MSH, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe as ri vlerësimit të tyre nuk ka respektuar dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-se, lidhur me nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, si dhe nenin 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik, ku nuk është kërkuar kurrfarë sqarimi shtese apo plotësim të dokumentacionit, madje nuk është respektuar as vendimi i OSHP-se të datës 11.09.2024 me nr 2024/0362. Ne si OE, përkatësisht anëtari i grupit për të cilin kemi potencuar se nuk ka prezantuar ISO certifikata e tilla, i njëjti me datën 02/02/2024, date kjo para hapjes së ofertave, ka kontraktuar organin certifikues ku me datën 05/04/2024, anëtari i grupit është certifikuar me ISO certifikatat përkatëse.

Kjo çështje është trajtuar me super ekspertize të autorizuar nga OSHP, ku qartë është përcaktuar se: “AK përmes “sqarimeve” ka konstatuar se Certifikatat për ISO 9001, 14001 dhe 45001 kërkojnë për të gjithë anëtarët e grupit, AK ka bërë korrigjimin e Dosjes së tenderit dhe si rrjedhojë tani kemi kërkesa kundërthënëse në dosje të tenderit dhe sqarimeve të dhëna nga AK. Meqë kërkesa në dosje të tenderit dallon nga sqarimet e dhëna, në mungesë të dispozitave të përshtatshme të LPP-së për kërkesa të paqarta të dosjes, eksperti shqyrtues bazuar në parimet e ligjit të marrëdhënieve dhe detyrimeve neni 86 - Dispozitat e paqarta, në raste të veçanta, rastin

kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër”. Andaj vlerësojmë se edhe kërkesat e dosjes të ndryshuara përmes “s qarimeve” të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e dosjes, duhet të interpretohet në dëm të hartuesit të dosjes, gjegjësisht në dëm të Autoritetit kontraktues dhe në dobi të OE-ve ofertues. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar”. Madje Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, për situatë tipike identike ne procedura tjera pavarësisht ofertimit ne grup është procedura tutje dhe është lidhe kontratë me certifikata te prezantuar vetëm nga njeri anëtar i grupit. Këto fakte neve si grup i OE- ve i kemi te evidentuara dhe te administruar. Prandaj arsyetimi i eliminimit te potencuar ne letër standarde te datës 21.11.2024, ndaj grupit te OE-ve ankues, lidhur me atë se anëtari i grupit “Industria Metalike e Kosovës” shpk, nuk ka prezantuar ISO Certifikimet, tregon për qellim te caktuar, eliminim te kompanisë sonë pavarësisht se kemi plotësuar te gjitha kërkesat kualifikuese te përcaktuara ne Dosje te Tenderit gjegjësisht sqarimet e ofruara dhe ndryshimet e aplikuara përmes formularëve standard korrigjues te publikuar para hapjes se ofertave. Për këtë çështje edhe KRPP ne ueb faqen e saj tek rubrika “Interpretimet Ligjore”, te publikuar me datën 22/06/2023 ka dhënë sqarimin ku trajtohet dhe sqarohet çështja e certifikatave për sigurimin e cilësisë, ku potencohet: “Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohe në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit. Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillen nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit. Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t’i specifikojë qartë kërkesat që duhet t’i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.” Sipas dispozitave ligjore dhe opinionëve te KRPP-se, tek projektet qe kane te bëjnë me realizimin e kontratave te punës, AK-MSH, ndaj operatoreve ekonomik nuk mund te aplikojë certifikata për sigurimin e cilësisë por mund te aplikojë certifikata te tilla ndaj produkteve përkatësisht për kontrata qe kane te bëjnë me realizim te shërbimeve dhe furnizimeve.

Pretendimi ankimor 5: Grupi i OE-ve ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, sa i përket ofertave tjera te cilat kane ofertuar me çmim me te ulet se oferta e grupit te OE-ve ankues, përveç arsyetimeve te eliminimit te përshkruara ne letër standarde dhe ne raport te ri vlerësimit te ofertave te njëjtat oferta kane edhe mangësi tjera lidhur me kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar si dhe me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nga neni 68 dhe 69 i LPP-se dhe nuk janë raportuar te gjitha mangësitë dhe atë lidhur me konfirmimet bankare, përvojën dhe kualifikimet e stafit kyq apo edhe projekteve paraprakisht te realizuara si dhe nuk janë prezantuar certifikime adekuate ndaj stafit tjetër mbështetës.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “4AM & Raf II” Nr. 1202/2024 janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti kontraktues me dt.02.04.2024 kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e saj të parë, ku ishte shpërblyer për kontratë kompania BM Group SH.P.K, ndërsa ne ishim eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit. Kundër këtij vendimi ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.07.04.2024, ku e kishim sqaruar se arsyet e AK-së për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim: Të dy arsyet e eliminimit (të dhëna në vlerësimin e kaluar) janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sa i përket z. Nazmi Hoxha e ku thuhet se është i kualifikuar si teknik i ngrohjes, për kaldaja me avull dhe me ujë të ngrohtë, ndërsa është kërkuar instalues gazi, ju sqarojmë se në këtë rast ka ndodh një lëshim teknik, sepse në listën e stafit teknik tek profesioni për z. Nazmi Hoxha është shënuar instalues gazi, ndërsa tek z. Samit Hasa saldues metali. Ndërsa dokumentet e z. Samit Hasa janë të bashkangjitura dhe dëshmojnë se ky punëtor është i certifikuar për saldues të gazrave, kurse z. Nazmi Hoxha është saldues i kaldajave dhe metaleve. Pra nga këto sqarime kuptohet se në listë ka një lëshim teknik tek përkrahimi i profesionit në lidhje me këta dy punëtorë kurse kur analizohet dokumentacioni i tyre, kuptohet qartë se z. Samit Hasa është i certifikuar saldues i gazrave, ndërsa z. Nazmi Hoxha është saldues i kaldajave dhe metaleve. Autoriteti kontraktues është bazuar vetëm tek lista e punëtorëve teknik, ndërsa nuk ka analizuar dëshmitë dhe dokumentet tjera për këta dy punëtorë. Bashkangjitur kemi certifikatën e salduesit të gazrave z. Samit Hasa, edhe pse këto dëshmi janë pjesë e dosjes së tenderit, prandaj në këtë rast ekziston një lëshim teknik dhe i cili konsiderohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 të LPP-së. Në lidhje me këtë mungesë të certifikatës, autoriteti kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, përderisa kanë qenë të bashkangjitura të gjitha dëshmitë e tjera të këtij personi.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit në lidhje me planin dinamik, ju sqarojmë se ne e kemi plotësuar planin dinamik pikërisht ashtu siç është kërkuar. Arsyeja e dhënë se është plotësuar në mënyrë joreale për punët inxhinierike, për neve është arsye abstrakte dhe plotësisht e paarsyeshme, pasi që nuk e kuptojmë se çka do të thotë në mënyrë joreale. E rëndësishme është se plani dinamik është plotësuar dhe dorëzuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, ndërsa nuk është kërkuar diçka tjetër të plotësohet në plan dinamik, prandaj kjo arsye është plotësisht e paqëndrueshme dhe imagjinare. Tek specifikimet teknike është përcaktuar ndër të tjera si në vijim: Afati kohor i planifikuar i përfundimit të tërësishmen të punimeve përfshirë pranimin e përkohshëm të punimeve dhe pranimit-dorëzimit të objektit duhet të jete jo me shume se 30 muaj kalendarik. Edhe i e kemi ofruar planin dinamik sipas kësaj kërkesë me planifikimin që punimet do të kryhen brenda 30 muajve. Edhe pse kërkesa për plan dinamik nuk ka qenë kërkesë e kualifikueshmërisë. Neni 56.3 i LPP-së ndalon eliminimin për kërkesa që nuk janë pjesë e dosjes së tenderit, prandaj në këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë kur na ka eliminuar. Autoriteti kontraktues është arsyetuar se kinse ne jemi palë pa interes, mirëpo edhe pse ne nuk kishim vazhduar me ankesë në OSHP, disa OE të tjerë kishin parashtruar ankesë kundër vendimit të AK-së, ndërsa OSHP kishte nxjerr vendimin me nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362 dhe 2024/0367, me dt. 11.09.2024, ku me të cilin vendim është detyruar autoriteti kontraktues që lëndën ta kthej në rivlerësim. Përderisa lënda është kthyer në rivlerësim pra në pikën zero, atëherë autoriteti kontraktues nuk mund dhe nuk duhet në asnjë mënyrë që të na eliminoj me arsyetimin se jemi palë pa interes sepse asnjë dispozitë e LPP-së apo e ndonjë rregullore për prokurim publik nuk e parashih një veprim të tillë dhe nuk e përcakton që mund të quhet palë pa interes një OE nëse nuk kishte parashtruar ankesë ndaj një vendimi fillestar të AK-së, ndërsa më pastaj ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë

pas rivlerësimit. Përderisa ne kemi ofertuar dhe përderisa na janë dërguar kërkesat për vazhdim të validitetit dhe sigurimit të ofertave edhe për dy herë të tjera, dhe përderisa ne i kemi vazhduar çdo herë vlefshmërinë dhe sigurimin e ofertës, atëherë kuptohet qartë se ne jemi palë e drejtpërdrejtë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit, e për më tepër jemi edhe OE i përgjegjshëm. Fillimisht sigurimin e tenderit e kemi vazhduar me dt.08.07.2024, ndërsa më pastaj me dt.09.10.2024, ndërsa edhe ky fakt tregon qartë se ne jemi palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit, sepse kemi vazhduar sigurimin e tenderit dhe kemi bërë shpenzime të vazhdueshme në lidhje me këtë tender. Bashkangjitur keni të dy vazhdimet e sigurimit të tenderit.

Vendimi i AK-së për të na konsideruar palë pa interes është vendim arbitrar, subjektiv dhe i njëanshëm pasi që nuk ka asnjë mbështetje në dispozita të LPP-së. Secili vendim i cili nuk është i mbështetur në ndonjë dispozitë të Ligjit është kundërligjor dhe duhet anuluar, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të ndalojë veprimet e kundërligjshme të AK-së. Për OE të mëposhtëm që janë me çmim më të lirë se sa oferta jonë, konstatojmë se janë të papërgjegjshëm dhe arsyet e eliminimit nga AK në njoftimin mbi vendimin e kaluar, janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur vetëm po i vendosim arsyet të cilat i kishte dhënë autoriteti kontraktues.

OE “Ada Consulting Group SHPK & Architecture SHPK & Vëllezërit Asllani SHPK & Progen SHPK është i papërgjegjshëm me arsyet edhe të cilat i ka dhënë autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e kaluar: Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiar. Garancioni ofruar është me kushtëzim nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrahja financiare deri në 4 e jo siç është kërkuar i pakushtëzuar. Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Nuk ka dëshmuar punë të kryera për dyer X-ray Automatike. Lidhur me punimet X-ray të Klinika e Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimi teknik. Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 4.10 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Mungon Certifikata për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë, z. Ahmet Morina. E ka prezantuar një Vendim nga MFPT, por jo certifikatën siç është kërkuar. OE “Standard Beton SHPK & Arifaj SHPK & Liv Global Yapi Insaat Taahhut v Ticaret Limited Sirketi” është i papërgjegjshëm me arsyet edhe të cilat i ka dhënë autoriteti kontraktues: Nuk e kemi ofruar Deklaratën në betim për liderin e konsorciumit Liv Global Yapi İncaat Taahhiit veTicaret Limited Çirketi. Nuk e kemi plotësuar si duhet Marrëveshjen e Konsorciumit - Nuk i kemi plotësuar 3 kushtet e marrëveshjes për liderin e konsorciumit Liv Global Yapi İncaat Taahhiit ve Ticaret Limited Çirketi.

Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - E ka ofruar një Deklarate nga BKT Shqipëri e datës 13.07.2023 që Arifaj ka kredituar 36,415,552 lek, por pa të dhëna të projektit. E ka ofruar edhe një konfirmimin nga Credins Bank Shqipëri e dt. 24.11.2023 që Arifaj posedon në llogari 376,000.00 euro.

Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 1 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, për ISO certifikatat e kërkuara. Vetëm Standard Beton i posedon të gjitha ISO-te. Arifaj posedon vetëm ISO 9001. E ka ofruar ISO 9001:2015 lurke me afat të skaduar 15.08.2023 e cila nuk i përket kompanisë Liv Global por një prodhuesi të paneleve elektrik BASKENT ELEKTRIK TABLO..., si dhe ISO 14001:2015 turke e cila nuk i përket kompanisë Liv Global por një prodhuesi të paneleve elektrik BASKENT ELEKTRIKTABLO...

Te Aneksi 1 i DT është kërkuar qe OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit, max. 30 muaj. Planin Dinamik e keni ofruar te pa plotësuar. Këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. OE “Teskon Proses Degerli Madenlar Finansal Danismanlik Tic LTD St&Fidola SHPK&Barbaros Mh Alzambak Sk Varyap Meridian Grand Tower është i papërgjegjshëm.

Këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me dt.09.12.2024, ku është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si e papabuar kurse janë aprovuar pjesërisht dy pretendimet tona ankimore përkitazi me ofertën tonë.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimore se jemi eliminuar pa të drejtë përkitazi me dëshmitë e Instaluesit të gazit, AK-së na ka aprovuar pjesërisht këtë pretendim, mirëpo sqarojmë se ky pretendim është plotësisht i bazuar sepse ne realisht kemi bërë një lëshim teknik tel lista e stafit mirëpo dëshmitë janë të ofruar në harmoni me kërkesat e dosjes përkitazi me salduesin e gazrave z. Samit Hasaj dhe për salduesin e kaldajave dhe metaleve z. Nazmi Hoxha. Edhe vetë AK-së në përgjigje e ka pranuar se dëshmitë për z. Samit Hasaj janë në rregull, prandaj pretendimi në këtë pikë është dashur të konsiderohet plotësisht i bazuar dhe se ne e plotësojmë këtë kërkesë plotësisht dhe sipas kërkesës së FDT-së. Edhe pretendimi tjetër në lidhje me arsyen e eliminimit përkitazi me planin dinamik është aprovuar pjesërisht si i bazuar, mirëpo edhe ky pretendim është dashur të konsiderohet plotësisht i bazuar pasi që edhe nga vetë AK-së është cekur se plani dinamik nuk ka qenë kriter kualifikues. Duke pasur parasysh këtë fakt për neve është e habitshme se përse nuk

është vlerësuar plotësisht i bazuar pretendimi ankimor.

Sa i përket konstatimit se neve na është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si palë pa interes sepse nuk kishim parashtruar ankesë në OSHP, sqarojmë se ashtu siç e kemi cekur edhe me lart ne jemi pale me interes pasi qe rivlerësimi i ofertave është pika zero dhe po ashtu ne çdo herë e kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit duke bërë shpenzime të mëdha, prandaj kompania jone është e përgjegjshme dhe po ashtu palë me interes ne këtë aktivitet të prokurimit. Se ne jemi te përgjegjshëm faktikisht e ka pranuar edhe vet AK, në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, prandaj ne duhet te jemi fitues të këtij tenderi. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 43 të RRPP Nr.001/2022, sepse ne nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita, kurse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues i këtij tenderi. Gjithashtu nuk e është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm sepse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BM Group” Nr. 1232/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pjesa 1. Autoriteti Kontraktues: me publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka bërë shkelje të: Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ku i njëjti ka paraqitur në këtë njoftim dokumentacione të cilat nuk janë reale, të cilat mund të kërkohen me nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik, ku Autoriteti me respektimin e këtij neni. Lidhur me arsyen e eliminimit: Kompania “BM Group SHPK” e ka plotësuar në përpikëri kushtin për të cilin jemi eliminuar. Ne dosje të tenderit është kërkuar që si pune të kryera të jene mbi 25 milion euro vlere e punëve ne si kompani për tri vitet e fundit kemi certifikuar listën e punëve të kryera. Sipas vendimit të AK: Sipas nenit 69 asnjëra nuk është e cekur se kontratat duhet të jene plotësisht të përfunduara që të këtë certifikatën e punëve të kryera apo referencën saktësisht është thënë që OE duhet të këtë Referencën për punët e kryera çka do të thotë për punët që ka përfunduar deri ne at moment të këtë një pranim teknik apo reference që AK apo investitori për të cilin ka kryer pune, ato pune të jene të pranuar teknikisht. Sipas këtij neni ne si OE kemi plotësuar me saktësi kontratën pasi që me sqarim e kërkuar nga AK kemi ofruar edhe dëshmitë qarkullimet bankare me investitorët privat. Kjo do thotë që çdo pune e përfunduar për të cilën kemi reference dhe qarkullime bankare duhet të pranohet pa marre parasysish se asht e përfunduar marrëveshja komplet. Poashtu po ju dërgoj edhe një here sqarimet e kërkuara nga vet ju të datës 30.10.2024 ne të cilën janë të cekura detajisht titulli i kontratës, vlere e kontratës si dhe qarkullimet bankare për secilin investitor sidomos ata private. Ne mendojmë poashtu pasiqe ne kemi ofruar sqarime të mjaftueshme ne kërkesën tuaj për këtë pike nuk ka qene e drejte të anulohemi për arsyetimin e njëjtë. Ne baze të këtij neni neve si OE na është bere e pa drejte anulimi nga kjo gare pasi jemi OE me i denje dhe me i kompletuar si dhe me çmimin me të favorshëm për fitimin e këtij aktiviteti të prokurimit Ne vazhdim për secilin projekt të insistuar që keni të bashkangjitur arsyetimet se perse duhet ti pranoni projektet për të cilat keni thënë që nuk i plotësojnë kushtet. Ne këtë projekte janë pranuar punët të cilat janë përfunduar deri me këtë date. Vazhdimi i projektit është bërë pas kësaj date dhe një marrëveshje të re me AK. Deri ne at date kane qene ato pune të kryera dhe AK ka lëshuar reference për punët që janë përfunduar me sukses.

Ky ndryshim ne mes kontratës dhe ka ndodhur pasiqe ne fillim projekti ka qen ndryshe i propozuar dhe koke pas kohe kanë ardhë me deri ne projektin përfundimtare janë shtuar punët dhe për këto pune të përfunduar ka pasur pagesa dhe fatura të lëshuara. Pasiqe që është projekt ndermet një organizate e jashtme dhe me një autoritet kontraktues është lehte të vërtetohen a janë pune të përfunduara. Neve ne email na është përcjellë ne këtë forme nga Unopsi dhe për këtë kjo është e pranuar. Poashtu duke pasur parasysish që ky projekt është bere ne spitale është e lehte të kontaktoni. Poashtu ja përcjellim edhe screenshot referencën e dërguar me email nga AK-investitori. Pasiqe që është projekt ndermet një organizate e jashtme dhe me një autoritet kontraktues është lehte të vërtetohen a janë pune të përfunduara.

Neve ne email na është përcjellë ne këtë forme nga Unopsi dhe për këtë kjo është e pranuar. Poashtu duke pasur parasysish që ky projekt është bere ne spitale është e lehte të kontaktoni. Poashtu ja përcjellim edhe screenshot referencën e dërguar me email nga AK-Investitori. Pasiqe projekti është ne dy faza dhe të dy fazat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe të dy fazat janë duke u punuara nga ne.

Ne referencën e lëshuar janë punët e përfunduara me sukses. Ky projekt ende nuk është përfunduar pasiqe përfundimin final e ka me 31.05.2025. Por ne kemi kërkuar reference nga

Invesitori për punët e përfunduara me deri me atë date- te cilat janë te vërtetuara me situacione dhe referenca është lëshuar për ato pune. Duke pasur parasysh qe kontrata ka qen te përfundohet reference janë paraqitur punët te cilat janë përfunduar deri me situacione dhe pagesa te kryera. Duke pasur parasysh qe kontrata është për tu përfunduar komplet deri me 31.12.2025 ne vlere prej 12.5 milion euro. Ne reference janë paraqitura punët te cilat janë përfunduar deri ne shkurt 2024. Kontrata e marrëveshjes përfshinë shume projekte. Përfshinë ndërtimin e depove e Objekteve te ndryshme te cilat janë përfunduara, përfshinë Bau Marketin ne Peje te cilin ka hy ne funksion ne 2023 depo e hapur dhe depo te mbyllur te cilat janë te përfunduara ne 2023. Nuk mund te refuzohen punët te cilët kane përfunduar me sukses dhe janë te pranuar nga Investitori te cilat te gjitha janë te paraqitura me situacione dhe pagesa përmes banke. Për ta dëshmuar secilën pune ne ju ofrojmë situacionet për punët e kryera dhe te pranuar deri me atë date. Normale qe referenca lëshohet pas njoftimit te kontratës për projektet te cilat janë ne kontrata ose marrëveshje afat gjate pasi qe nuk dihet kur do del një projekt për këtë situacionet janë dëshmi qe punët janë pranuar .

Pjesa 2. Anulimi i aktivitetit. Po ashtu, AK këtu ka vepruar edhe ne kundërshtim me nenin: 62 te LPP. ku thekson: Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit. Duke e konsideruar veten si operatori ekonomik me i përgjegjshme nga ato qe kemi dëshmuar me sipër, konsiderojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62 [Përfundimi i Aktivitetit te Prokurimit] çdo tentim për te injoruar te gjitha këto prova/dëshmi, besojmë se është i qëllimshëm dhe ne mbrojtje te se keqes dhe jo ligjores. Andaj, çdo tentim nga kushdo qe te konsideroj si ndryshim material, ose jo plotësim i kërkesës, nga ne do konsiderohet se është një veprimi qëllimshëm për dëmtimin e kompanisë sonë, e qe sa për informim, veprime te tilla te qëllimshme për tu shkaktuar dem palëve tjera, tejkalojnë procedurën administrative te zhvilluar për një aktivet te prokurimit publik, duke hyre edhe ne fushën penale, dhe qe për bindjen tone si OE i përgjegjshëm, i eliminuar ne mënyrë te kundërligjshme jemi te detyruar qe përveç mjeteve juridike te garantuara me dispozitat e LPP-se, ne një mënyrë edhe përkundër vullnetit tone, te vlerësojë edhe mundësinë e hapjes se një procedure penale ndaj vendimmarrësve ne AK, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat e Kodit Penal te Kosovës, krejt kjo me qellim qe shkelësit e ligjit te mos mbeten pa u ndëshkuar, duke u amnistuar për shkeljet ligjore vetëm me një anulim te vendimmarrjes se tyre nga organi përfundimtar ne procedurën e vendimmarrjes si pas LPP-se, respektivisht anulimin e vendimmarrjes nga OSHP.

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve sipas neni 108/ A: Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës sonë për ri-shqyrtim te bere me datën 26.11.2024. Autoriteti kontraktues, gjegjësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duke vepruar ne këtë mënyrë ka bere shkelje te rende siç parashihet me nenin 97 te Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik, kur mirret parasysh kërkesat/obligimet ligjore, shih citatin: "6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtoje kërkesën brenda tre (3) dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit ose, kur është e zbatueshme nga data e marrjes se informatave shitesë dhe dokumenteve te parashikuara ne paragrafin 5 te këtij neni. Aty i përmendur me ne raste specifike te justifikuara mund te zgjatet për jo me shume se tre (3) dite shitese. dhe ankuesi do te informohet për këtë."

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1186/24, 1191/24, 1200/24, 1202/24 si dhe 1232/24 ndërsa me datë 18.02.2025 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtuese.

Lidhur me ankesën nr. 1186/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të mbetet në fuqi”*.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1186/24 të operatorit ekonomik “Ada Consulting Group” Sh.P.K

Pretendimi nr. 1: Pretendimi i parë ankimor sipas ankesës 1186/24 ka të bëjë me arsyen e parë të eliminimit, ku sipas AK-së i njëjti OE nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për para të gatshme në bankë ose qasje të pakushtëzuar në kredi. Eksperti shqyrtues sqaron se kjo çështje është trajtuar përmes raportit të ekspertit nr.367/24, ku pas kërkesave të ekspertit drejtuar bankave të të gjithë OE-ve ankues, për të konfirmuar nëse ato (bankat) ofrojnë siguri/garanci se klientit të tyre do ti jepet kredia në rast se të njëjtit janë fitues të këtij tenderi, banka e OE ankues në rastin konkret, ka qenë njëra nga bankat e dy OE-ve ankues që i janë përgjigjur pozitivisht kërkesë tonë, duke konfirmuar dhënien e kredisë për OE në fjalë. Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar

Pretendimi nr. 2: Arsyja e dytë e eliminimit të OE ankues, është se i njëjti “Nuk ka dëshmuar punë të kryera për dyer X- ray Automatike. Lidhur me punimet me X-ray të Klinika e Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimi teknik”.

Pas analizimit të ofertës së OE ankues, ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik kanë gjetur se i njëjti ka ofruar dëshmi kontratën me QKUK për vazhdimin e punimeve në klinikën e Ortopedisë, ku sipas raportit për pranim teknik janë edhe “Dyer Hermetike INOX me veshje Plumbi”. Përveç kësaj OE ankues ka ofruar vetëm një raport për pranim të pjesshëm të punëve, i cili raport shënon

komisioni gjatë punës ka verifikuar funksionimin e dyerve, instalimeve elektrike etj...dhe se komisioni ka kërkuar përmirësimin e vërejtjeve të evidentuara gjatë punës në terren. Eksperti shqyrtues dhe ekspertit teknik vlerësojnë se raporti si i tillë nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që OE nuk ka dorëzuar pranimin teknik final të projektit para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave. OE ankues pretendimin e tij e mbështet në faktin se punimet lidhur me dyert X-ray janë kryer më herët se afati i fundit për dorëzim të tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se në rastin konkret kërkesa e dosjes ka qenë për “projekte të realizuara”, dhe sipas vlerësimit tonë asnjë projekt nuk mund të quhet i realizuar nëse për atë projekt nuk ka pranim final/përfundimtar nga ana e AK-së.

Ekspertet shqyrtues përmes raportit 367/24 përveç tjerash kanë rekomanduar që në rast të rivlerësimit AK të konfirmoj nëse ky projekt ka qenë i përfunduar në tërësi para afatit të fundit për dorëzim të tenderit duke i kujtuar AK-së që dëshmitë lidhur me këtë çështje duhet të jenë në pajtim dispozitat e nenit 72, për dokumente që në mënyrë të objektive mund të vërtetohen se kanë ekzistuar para hapjes së ofertave. Në rastin konkret dëshmia (pranimi final) nuk ka ekzistuar para datës së hapjes së ofertave dhe pranimi i të njëjtës si sqarim/plotësim i ofertës vlerësojmë do ishte në kundërshtim me nenin 72 par.3 të LPP-së. Bazuar në këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimor i pabazuar.

Pretendimi nr.3: OE ankues pretendon se AK nuk ka respektuar afatin ligjorë për kthimin e përgjigjes në kërkesë për rishqyrtim 3+3 ditë. Pas analizimit të shkresave të lëndës kemi gjetur se pretendimi ankimorë është i bazuar, pasi AK ka tejkaluar afatin për kthim të përgjigjes të paktën për 1 ditë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 1191/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të mbetet në fuqi”*.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1191/24 të operatorit ekonomik “AK Invest Doel Tetovo & Hidro Project Sh.P.K”

Pretendimi nr. 1: Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 1191/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesën për para të gatshme në bankë ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 4,000,000€. OE ankues pretendon se e plotëson këtë kërkesë bazuar në dëshmitë e ofruar nga tri banka, të cilat dëshmi i ka bashkangjitur kërkesës/ankesës. Pas analizimit të dëshmimeve të ofruara nga OE vlerësimi i ekspertit është se përveç dëshmisë së ofruar nga banka Sparkasse në vlerë 1,250,000€, dy referencat tjera nuk dëshmojnë se OE ankues plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike, eksperti shqyrtues me rastin e shqyrtimit të ankesës 362/24 në atë kohë i është drejtuar me kërkesë për sqarim Banka e cila ka lëshuar letër referencën për OE, me pyetjen: Drejtuar bankës HALBANK ‘Thas the credit line of your client of €2,000,000 already been used, and if so, how much was the remaining/available amount on 13.02.2024.’ (Linja kreditore e klientit tuaj prej 2,000,000€ a është shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë vlera/shuma e mbetur me 13.02.2024)

Pyetja drejtuar bankës Stopanska Banka: ‘Has the credit line of your client of €2,000,000 already been used, and if so, how much was the remaining/available amount on 15.02.2024.’ (Linja kreditore e klientit tuaj prej 2,000,000€ a është shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë vlera/shuma e mbetur me 15.02.2024). Deri në ditën e dorëzimit të raportit 362/24 me 15.08.2024 eksperti shqyrtues nuk ka pranuar përgjigje konkrete nga bankat përkatëse, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.2: Pretendimet ankimore sa i përket stafit të OE ankues, i cili pretendon se dëshmitë për stafin janë ofruar në pajtim me kërkesat e dosjes, eksperti shqyrtues/teknik pas analizimit të ofertës së OE ankues, sqarojnë se dëshmitë e ofruara për një pjesë të stafit përfshirë këtu edhe z. Nuhiu i prezantuar si menaxher i projektit, janë vërtetim i kopjes nga kopja, pasi kontrata origjinale nuk i është prezantuar noterit, dhe si të tilla nuk plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Sqarojmë se kërkesa e dosjes ka qenë “kontrata të noterizuara”, dhe kjo kërkesë nuk plotësohet me vërtetim të kopjes nga kopja të kontratës, pa vërtetim të nënshkrimeve të palëve që lidhin kontratë në prani të noterit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.3: Pretendimi tjetër ankimorë është se AK nuk ka respektuar afatin ligjorë për kthim të përgjigjes në rishqyrtim. Pas analizimit të shkresave të lëndës kemi gjetur se OE ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me 26.11.2024 ndërsa AK ka publikuar vendimin për refuzim me 09.12.2024, andaj vlerësojmë se AK tejkalluar afatin ligjorë për kthim të përgjigjes se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik është deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 1200/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të mbetet në fuqi”

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1200/24 të operatorit ekonomik “Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt&IMK -Industria Metalike E Kosovës SH.P.K.”

Pretendimi nr. 1: Për pretendimin ankimor nr.2 të OE-Mabco Constructions SH.P.K-Planin Dinamik, ekspertja teknike konstaton: Pas shqyrtimit të dokumentacionit - “Planit Dinamik Final Klinika Emergjente” bashkëngjitur në dosje të tenderit nga OE, vërtetohet se Plani Dinamik i prezantuar nuk i përmbushë kërkesat teknike të AK-MSH.”OE duhet të dorëzon me ofertën e tij” Planin Dinamik të Detajuar” duke plotësuar formën standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shtesë tek dosja e tenderit.

OE nuk ka dorëzuar Planin Dinamik siç është kërkuar nga AK në Planin Dinamik të publikuar si dokument shtesë tek dosja e tenderit ,konkretisht OE nuk e ka përfshirë kapitullin H4- numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Realisht OE ankues në plan dinamik i mungon në tërësi kapitulli FI4-Pajisjet Sanitare. Pasi që në fushën e ndërtimit asnjë dispozitë ligjore nuk përcakton formën standarde të “Planit Dinamik” të zhvillimit të punimeve sipas dispozitës së nenit 44 paragrafi 4 të rregullores Nr.001/2022, për Prokurimin Publik, në këtë rast ka qenë në diskrecion të AK të përcaktoj formën standard të Planit Dinamik. Andaj, bazuar në konstatimet e lartcekura pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi nr. 2: OE ankues pretendon se nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 108/A sa i përket trajtimit të kërkesës dhe afatit ligjor për përgjigje në kërkesë, si dhe nuk janë respektuar dispozitat e neni 59 të LPP lidhur me 40 të R.RPP për afatet ligjore lidhur me ekzaminimin dhe vlerësimin ofertave. Pas analizimit të shkresave të lëndës eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK edhe në kërkesë për rishqyrtim e po ashtu edhe në vlerësim ka tejkalluar afatet ligjore.

Pretendimi nr. 3: Në lidhje me pretendimin e OE ankimor për Kërkesën mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 gjegjësisht mosplotësimin e Dëshmisë së kërkuar dokumentare për

Certifikatat profesionale valide për ISO 9001, 14001, 45001 dhe 3834-2, si dhe sqarimeve të AK-së, dt. 05.02.2024. Eksperti shqyrtues sqaron se sipas dosjes së tenderit, kjo kërkesë është kërkesë mbi kapacitetin teknik/profesional dhe si e tillë në pajtim me dispozita të LPP-së dhe legjislacionit sekondar, kërkesat për kapacitet profesional/teknik aplikohen ndaj grupit si tërësi, e

jo ndaj secilit anëtar veç e veç.

Megjithëse AK përmes “s qarimeve” ka konstatuar se Certifikatat për ISO 9001, 140001 dhe 45001 kërkohen për të gjithë anëtarët e grupit, AK nuk ka bërë korrigjimin e Dosjes së tenderit dhe si rrjedhojë tani kemi kërkesa kundërthënëse në dosje të tenderit dhe s qarimeve të dhëna nga AK.

Meqë kërkesa në dosje të tenderit dallon nga s qarimet e dhëna, në mungesë të dispozitave të përshtatshme të LPP-së për kërkesa të paqarta të dosjes, eksperti shqyrtues bazuar në parimet e ligjit të marrëdhënieve dhe detyrimeve neni 86 - Dispozitat e paqarta, në raste të veçanta, rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër”. Andaj vlerësojmë se edhe kërkesat e dosjes të ndryshuara përmes “s qarimeve” të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e dosjes, duhet të interpretohet në dëm të hartuesit të dosjes, gjegjësisht në dëm të Autoritetit kontraktues dhe në dobi të OE-ve ofertues. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi nr.4: Pretendimi tjetër ankimorë është se sipas OE ankues të gjithë OE-të tjerë me çmim më të lirë janë të papërgjegjshëm pasi nuk plotësojnë kërkesat e dosjes. Me qenë se OE ankues nuk ka pretendim konkret se cili OE cilat kërkesa nuk i plotëson, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është vetëm pjesërisht i bazuar pas parasysh ankesat dhe raportet e ekspertit për ato ankesa lidhur me këtë aktivitet.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik nuk është pajtuar mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 1202/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në s qarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të mbetet në fuqi”*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1202/24 të operatorit ekonomik “4AM & Raf II”

Pretendimi nr. 1: Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 1202/24 ka të bëjë me arsyen e AK-së për shpalljen si palë pa interes të OE ankues, pasi sipas AK-së, ky OE është eliminuar përmes letrës standarde me 02.04.2024 dhe i njëjti në atë kohë nuk ka ushtruar ankesë OSHP-së, me çka i bie se i njëjti është pajtuar me eliminim e tij. Pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se OE ankues në rastin konkret është eliminuar me datë 02.04.2024, pas të cilit eliminim i njëjti nuk ka ushtruar ankesë në OSHP. Ankesa e parashtruar tani pranë OSHP-së me të cilën OE e kundërshton eliminimin e tij konsiderojmë se është jashtë afatit ligjorë për më shumë se 8 muaj. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuar dhe se ankesa e OE ankues duhet të hudhet si palejuar. Përveç kësaj OE ankues ka ofruar një plan dinamik i cili nuk është në pajtim me kërkesat dhe kushtet e dosjes së tenderit, pasi nuk ka ofruar formën e përcaktuar nga AK për plan dinamik.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik nuk është

pajtuar mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 1232/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të mbetet në fuqi”*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1232/24 të operatorit ekonomik “BM Group”

Pretendimi nr. 1: Pretendimet ankimor të OE ankues kanë të bëjnë me arsyen e eliminimit, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesat për kapacitet teknik profesional. Eksperti shqyrtues sqaron se ky objekt i shqyrtimit (kontrata dhe referencat e BM Group) janë trajtuar përmes raportit të ekspertizës nr.367/24. Megjithatë përsërisim edhe një herë se: “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X- ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj.” Lidhur me projektet: Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjiilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovës, Faza e dytë - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse në Gjiilan, Pejë, Drenas dhe Studenqan, Furnizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe furnizimi i ndërtimit në Lagjen Marigona Hill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte OE i ankues për kontratë ka prezantuar kontratë dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve.

Përkundrazi në këto referenca shënon “Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratë deri më sot...”, “realizim i punimeve deri në masën 85%”, “... në punimet që po zhvillohen ...”, “... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...”, e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të cilat vërtetohen se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezulton që OE Ankues nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. OE i ankues nga AK, në listën e projekteve të realizuara ka 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka anekse kontrata.

Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimet ankimore se OE i ankues për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25.000.0006 janë të bazuara.

Në përgjigje të OE ankues për kontrata të cilat i ka në realizim e sipër, Shtojmë se kërkesa e dosjes është “projekte të realizuara” andaj asnjë projekt i cili nuk është i përfunduar në tërësi nuk mund të konsiderohet si projekt i realizuar, dhe asnjë shumë nga ato projekte të papërfunduara

nuk mund të pranohet si referencë në rastin konkret. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimorë për shkelje të nenin 108/A të LPP-së, pas analizimit të shkresave të lëndës vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK nuk ka kthyer përgjigje në afat ligjorë sipas dispozitave të LPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur. Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova si : raportin e ekspertizës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka ardhur në konstatim lidhur me ankesat e pranuar në këtë procedurë:

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “4AM & Raf II” me numër protokollit 2024/1202

Paneli shqyrtues e hedh poshtë ankesën e operatorit ekonomik “4AM & Raf II” për të cilin edhe eksperti shqyrtues konstaton se ankesa duhet hedhur si e palejuar për faktin se OE nuk paraqitur kundërshtim gjatë herës së parë që do të thotë nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në shkallë e dyte për të mbrojtur eliminimin e tij. Paneli Shqyrtues e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues dhe po ashtu, konsideron se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në

Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar të dt. 02.04.2024, nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës ndaj atij vendimi të autoritetit kontraktues konform dispozitave ligjore si palë e pakënaqur kundër vendimit të AK sipas nenit 109 të LPP. Këtë ankues nuk e ka bërë dhe si rrjedhojë është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit. Në momentin kur një OE pajtohet me eliminimin e tij duke mos e atakuar vendimin e AK konform këshillës juridike dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj, ky OE nuk mund ta ketë statusin e palës me interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Ngase, kjo lëndë është kthyer në ri-vlerësim vetëm për faktin se disa OE tjerë në këtë procedurë kanë paraqitur pretendime ankimore kundër eliminimi të tyre dhe të cilat janë kualifikuar si pjesërisht të bazuara. Për këto çështje OSHP qëndron konsistente në vendimet e saja sa i përket kësaj çështje dhe vlenë të theksohet fakti se në vendimet e saja nuk ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues që i kanë pasur ndaj OE të cilët kanë qenë të eliminuar dhe të cilët nuk e kanë mbrojtur veten me kërkesë për ri-shqyrtim/ankesë, duke i trajtuar si palë pa interes. Po ashtu edhe OE në ankesat e tyre, të rralla janë rastet kur atakojnë OE të cilët janë të eliminuar, të cilat as OSHP nuk i shqyrton ngase i klasifikojnë si palë pa interes dhe pretendimet i kanë vetëm ndaj të rekomanduarit apo ndaj atyre të cilët janë të pasuksesshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi. Ky konstatim ndërlihet edhe me njoftimin e publikuar në ueb faqen e OSHP të datës 09.02.2023, ku i lajmëron AK/OE, se OE për të kualifikuar si palë me interes janë të obliguar të paraqesin pretendime ankimore të cilat synojnë të mbrojnë eliminimin e tyre, në të kundërtën kualifikohen si palë pa interes.

Lidhur me ankesën e OE “Ada Consulting Group SH.P.K” me numër protokollit 2024/1186

Paneli Shqyrtues mbështet raportin e ekspertëve shqyrtues / teknik lidhur me raportin ngase kanë gjetur se i njëjti ka ofruar dëshmi kontratën me QKUK për vazhdimin e punimeve në klinikën e Ortopedisë, ku sipas raportit për pranim teknik janë edhe “Dyer Hermetike INOX me veshje Plumbi”. Përveç kësaj OE ankues ka ofruar vetëm një raport për pranim të pjesshëm të punëve, i cili raport shënon: komisioni gjatë punës ka verifikuar funksionimin e dyerve, instalimeve elektrike etj...dhe se komisioni ka kërkuar përmirësimin e vërejtjeve të evidentuara gjatë punës në terren dhe se raporti i ofruar nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që OE nuk ka dorëzuar pranimin teknik final të projektit para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave edhe pse OE ankues pretendimin e tij e mbështet në faktin se punimet lidhur me dyert X-ray janë kryer më herët se afati i fundit për dorëzim të tenderit mirpo nese i referohemi kërkeses se Dosjes se Tenderit, Njoftimit per kontrate dhe Formularit per permirisimin e dosjes ka qenë për “projekte të realizuara”, dhe sipas vlerësimit tonë asnjë projekt nuk mund të quhet i realizuar nëse për atë projekt nuk ka pranim final/përfundimtar nga ana e AK-së. Në rastin konkret dëshmia (pranimi final) nuk ka ekzistuar para datës së hapjes së ofertave ngase AK -ja gjate rivlersimit të ofertave sipas vendimit te OSHP -se me nr 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, ku eshte kerkuar aplikimi i nenit 72 të LPP se AK ja gjate rivlersimit të ofertave ka kerkuar sqarime tek Klinika e Ortopedisë -QKUK, dhe ne pergjigjen e marur rezulton se ky OE nuk ka ofruar ndonje raportë te pranimin teknik si rezultat i projekti te perfunduar me sukses sikurse është kërkuar. Andaj, PSH konsideron se ky OE ankues nuk ka ofertuar konform kërkesave të NJK/DT.

Lidhur me ankesën e OE “AK Invest Dooel Tetovo & Hidro Project SH.P.K” me numër protokollit 2024/1191

Paneli Shqyrtues nuk e mbështet në tërësi raportin e eksperti shqyrtues dhe teknik ngase ekspertër shqyrtues nuk ndalen fare në pasqyrimin e gjendjes reale dhe aktuale lidhur me

shqyrtimin e sqarime të sjellura, por të njëjtit vetëm i janë referuar raportit paraprak, kështu që gjate rivlersimit te ofertave Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime nga Bankat, ku ky OE ka ofruar letër referenc nga : HALKBANK- Shkup; STOPASKA BANKA dhe Sparkasse nga Republika e Maqedonise Veriore dhe sipas pretendimeve ankimore te elaboruara me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesën për para të gatshme në bankë ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 4,000,000€. Sipas ankese se deponuar OE ankues ka ofruar dëshmitë nga tri banka, të cilat dëshmi i ka bashkangjitur kërkesës/ankesës. Sipas formularit per eliminim ku thuhet se nuk kemi pranuar pergjigje nga banka brenda pesë (5) diteve Paneli Shqyrtues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime tek insitucionet tjera e jo nga OE pjesmarres e ne kete raste nuk mund te percaktoj vet afate kohore kur ato institucione duhet ti kthejne pergjigje sikurse ka vepruar, ngase kur kerkohet tek ndonje institucion tjetër e sidomos institucione jashtë vendit është jo autoritative të përcaktohen edhe afatet, sepse secili institucion i ka politikat apo regullate e saj të brendshme për kthimin e ndonje pergjigje zyrtare, rrjedhimisht në këtë rast AK -ja nuk mund të thirret në dispozitat ligjore të Ligjit per prokurim publik për kthimin e përgjigjeve , ngase këto regulla vlejné vetëm për palët e përfshiera në procedurat e prokurimit siq janë Operatorët Ekonomik dhe Autoriteti Kontraktues (autoriteti i cili inicion procedurën në fjalë), Andaj, në bazë të provave -fakteve ky OE ankues ka ofruar dëshmi reth ketyre konfirmimeve bankare, ku bankat si HALKBANK; STOPASKA BANKA dhe Sparkasse – Republika e Maqedonise Veriore, konfirmojnë se klienti i tyre ka limitet kreditore të lejuara konform kërkesës mbi gjendjen ekonomike/ financiare sipas Njoftimit per Kontratë, Dosjes se tenderit dhe Formularit mbi korigjimin e gabimeve. Ndersa lidhur me pretendimi nr.2: Pretendimet ankimore sa i përket stafit të OE ankues, i cili pretendon se dëshmitë për stafin janë ofruar në pajtim me kërkesat e dosjes sipas kërkesë se parashtruar nga AK tek Njoftimi per kontrate, Dosjes se tenderit dhe Formuarit per korigjimin e procedures tek kerkesat mbi mundesit profesionale/teknike tek deshmit e dokumentaura eshte kerkuar “kontrata të noterizuara”, pa u pershkruar qe duhet te jene te notraizuar nga orgjinale.

Paneli Shqyrtus vlerëson se AK-ja nuk mund ta diskualikoj nje OE nga procedura e prokurimit per nje kriter i cili nuk ka qenë i paraparë ne NJK dhe DT-se sikurse parashihet ne nenin 56.3 i LPP-se citoj’’ *Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*’’.Sipas vendimit te OSHP se me nr 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, ku nga gjetjet e panelit shqyrtues është kerkuar nga AK-ja qe gjate rivlersimit te aplikon nenin 72 e LPP-se ne raste se ka dyshime mund te kerkon informata sqaruse per te vertetuar aktin noterial apo ka mundur të aplikoj nenin 52.7 te LPP se.Mos respektimi i vendimeve të OSHP konform nenit 97 të Rregullores për Prokurimin Publik konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit. Kështu që, PSH konsideron se nuk qëndron arsyetimet për eliminimin e këtij OE ankues lidhur me këto pika.

Lidhur ankesën me nr me nr. 2024/1200“Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt & Imk - Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.”

Paneli Shqyrtues do të lëshohet vetën në pretendimet ankimore të cilat jane të përcaktuar në këtë vendim dhe në këtë rastë mbështet raportin ekspertit shqyrtues dhe / teknik ngase në ofertën e këtij OE ankues ne Planin Dinamik të ofruar mungon pershkrimi i punimeve tek H4- ku nuk janë të përfshiera (mungojne) 14 pozicione. Sipas DT se ku është e paraqitur forma 1 dhe 2 lidhur me Planin Dinamik ky OE ka perdorur vetëm formën 1 por jo edhe te plotesuar ngase siq u tha edhe me larte mungon pershkrimi i dinamikës ne realizimin e punimeve nga H4 , në 14

pozicione, ndërsa forma 2 nuk gjendet fare, kështu që ky Plan i ofruar nga ankuesi, nuk është ofruar sipas kërkesës së DT dhe si i tillë nuk ofron të dhëna të sakta rreth implementimit të këtij projekti, përfshirë edhe afatet e ekzekutimit të punëve. Kështu që, konform nenit 10 të Udhëzuesit për Prokurim Publik, Kur lista e çmimeve nuk është plotësuar, refuzo tenderin pa kërkuar informacion shtesë- Kusht administrativ. PSH konsideron se AK ka vepruar konform dispozitave ligjore për eliminimin e këtij OE ankues.

Lidhur ankesën e OE “BM Group” me numër protokollit 2024/1232

Paneli Shqyrtues e mbështet raportin e ekspertit shqyrtues dhe/ teknik sikurse edhe vendimin e AK-se ngase Pretendimet ankimor të OE ankues të cilat kanë të bëjnë me arsyen e eliminimit, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesat për kapacitet teknik profesional lidhur me kontrata dhe referencat e BM Group janë trajtuar përmes raportit të ekspertizës nr.367/24. Kërkesa e parashtruar nga AK sipas Njoftimit për Kontrate, Dosjes së Tenderit si dhe Formularit për korigjimin e procedurës e publikuar në platformën elektronike për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale/ teknike ku është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X- ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj.” Lidhur me projektet e paraqitura në ofertë sikurse : Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovës, Faza e dytë - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse në Gjilan, Pejë, Drenas dhe Studenqan, Furnizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe furnizimi i ndërtimit në Lagjen Marigona Hill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte ky OE ankues ka prezantuar kontratë dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve ashtu siq përkruet edhe në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik se në këto referenca shënon “Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratës deri më sot...”, “realizim i punimeve deri në masën 85%”, “... në punimet që po zhvillohen ...”, “... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...”, e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të cilat vërtetohen se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezulton që OE Ankues nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. OE ankues nga AK, në listën e projekteve të realizuara ka 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka anekse kontrata.

Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, sikurse në raportin e eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimet ankimore se OE i ankues për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25.000.0000 ashtu siq janë kërkuar kështu që Paneli Shqyrtues vlerëson se ky OE nuk ka përbushur kërkesën siq është kërkuar në NK,DT konform nenit 69 të LPP-

së, “projekte të realizuara ” andaj asnjë projekt i cili nuk është i përfunduar në tërësi nuk mund të konsiderohet si projekt i realizuar, dhe asnjë shumë nga ato projekte të papërfunduara nuk mund të pranohet si referencë në rastin konkret, këtë e ka vërtetuar edhe AK-ja gjatë rivlersimit të ofertave, sikurse është e pershkruar në B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se tek letra standarde për tenderuesin e eliminuar. Andaj, PSH konsideron se ky OE ankues nuk ka ofertuar konform kërkesave të NJK/DT.

Andaj, Paneli Shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik. Rrjedhimisht, anulohet njoftimi mbi vendimin e AK lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” me nr. të prokurimit: "206-23-14371-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë dhe lënda kthehet në ri-vlerësim, sipas arsytimit të lartcekur.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues/teknik lidhur plotësimin ose jo të kushteve të pershkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sipas arsytimit në vendim tek gjetjet e panelit sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., „Raf II"sh.p.k., MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K., AK INVEST DOOEL Tetovo, BM Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: